

Kodi i Sjelljes së Nxënësit



**Drejtoria Arsimore e
Filadelfias**

Viti Shkollor 2008-2009

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Komisioni i Reformës Shkollore

Sandra Dungee Glenn
Kryetare

Anëtarë

Denise McGregor Armbrister
Martin Bednarek
James P. Gallagher, Ph.D
Heidi A. Ramirez, Ph.D



Dr. Arlene Ackerman
Drejtore e Përgjithshme e Shkollave

Shawn Crowder
Shefe Kabineti

PASQYRA E LENDES

PARAGRAFI 1. HYRJE.....	1
1.1. Politika e Drejtorisë Arsimore.....	1
1.2. Motoja jonë- Mbështetja e sjelljes pozitive	1
1.3. Qëllimi i Kodit të Sjelljes së Nxënësit.....	1
1.4. Kufiri i Shtrirjes së Kodit.....	2
1.5. Politika e Barazisë për të Gjithë.....	2
1.6. E Drejta për Shërbime Gjuhësore.....	2
1.7. Fjalori i Termave.	2
PARAGRAFI 2. TE DREJTAT DHE PERGJEGJESITE E NXENESVE DHE PRINDERVE.....	4
2.1. Përgjegjësitë e Nxënësve.	4
2.2. Të Drejtat e Nxënësve	5
2.3. Përgjegjësitë e Prindërve/Kujdestarëve.....	5
2.4. Të drejtat e Prindërve/Kujdestarëve	5
2.5. Të Drejtat e Viktimës në Sulmet e Kryera në Shkollë.....	6
PARAGRAFI 3. SHKELJET E NXENESIT DHE PASOJAT	6
3.1. Niveli I-rë i Rregullave.....	7
Rregulli 1. <u>Ndalohet Prishja e Mësimit në Shkollë</u>	7
Rregulli 2. <u>Zbatimi i Kodit të Veshjes</u>	7
Rregulli 3. <u>Ndalohet mbajta e Ngjyrave dhe Simboleve të Bandave</u>	7
Rregulli 4. <u>Ndalohet Fjalori Banal/Fyes</u>	7
Rregulli 5. <u>Mandat/Rregullore për Ndërgjegjshmëri Akademike</u>	8
Rregulli 6. <u>Ndalohet Abuzimi me Kompjuterin ose i Privilegjeve të Internetit</u>	8
Rregulli 7. <u>Ndalohet Vjedhja dhe Shkatërrimi i Pronës</u>	8
Rregulli 8. <u>Ndalohet Kumari</u>	8
Rregulli 9. <u>Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit nga Pakujdesia</u>	8
Rregulli 10. <u>Ndalohen Kërcënimet</u>	8
Rregulli 11. <u>Ndalohen Zëniet/Rrahjet</u>	8
Rregulli 12. <u>Ndalohen Dhuna/Goditjet e lehta</u>	8
Rregulli 13. <u>Ndalohen Veshjet dekolte dhe Prekjet e Pahijsme</u>	8
Rregulli 14. <u>Ndalohen Produktet e Duhanit dhe e Mjeteve që lidhen me të</u>	9
Rregulli 15. <u>Ndalohen Droga dhe Pijet Alkolike</u>	9
3.2. Niveli II-të i Rregullave	9
Rregulli 16. <u>Thyerje të Përsëritura të Kodit</u>	9
Rregulli 17. <u>Ndalohet Shkatërrimi dhe Vjedhja e Pronës</u>	9
Rregulli 18. <u>Ndalohen Frikësimet, Brutaliteti dhe Kërcënimet Serioze</u>	9
Rregulli 19. <u>Ndalohen Ngacmimet seksuale/Kërcënimet</u>	10
Rregulli 20. <u>Ndalohen Aktet Seksuale me Dëshirë</u>	10
Rregulli 21. <u>Ndalohen Sulmet Seksuale me Forcë</u>	10
Rregulli 22. <u>Ndalohet Përdorimi i Dhunës ndaj Personelit të Shkollës</u>	10
Rregulli 23. <u>Ndalohet Dhuna/Goditjet e Rrezikshme</u>	10
Rregulli 24. <u>Ndalohet Grabitja</u>	10
Rregulli 25. <u>Ndalohet Mbajta e Armëve</u>	10
Rregulli 26. <u>Ndalohet Shpërndarja e Drogës ose Alkolit</u>	10
Rregulli 27. <u>Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit</u>	10
3.3. Proçes i Ndhmës së Gjithanshme të Nxënësit (<i>The Comprehensive Student Assistance Process, CSAP</i>): Një sistem i gjithanshëm ndërhyrjesh dhe masash në drejtim të zvogëlimit të pengesave, që bëhen shkak i prapambetjes në mësim.	11
3.4. Ndërhyrjet/Masat e Duhura në rastet e Shkeljes së Kodit, për Nxënësit e Kopshtit	11
3.5. Ndërhyrjet/Masat e Duhura ndaj Dhunimit të Kodit për Nxënësit nga Klasat 5-12	16

PARAGRAFI 4. PROÇEDURAT DISIPLINORE	22
4.1. Proçedurat e Pezullimit nga shkolla deri në 3 ditë.....	22
4.2. Proçedurat e Pezullimit nga shkolla më shumë se 3 ditë	22
4.3. Proçedurat për Transferime në një Shkollë Tjetër për Nxënësit e Klasave të K- 4 (Kopsht- 4)....	22
4.4. Proçedurat e Transferimit në Shkolla Alternative për nxënësit e klasave të 5-12.....	22
4.5. Proçedurat e Përgjashtimit.....	23
4.6. Proçedurat për Disiplinën në klasat e Arsimit Special (<i>Special Education</i>).....	23
4.7. Pasojat në rast shkelje të Kodit të Sjelljes sipas të Drejtës Penale (<i>Criminal Justice</i>) dhe e të Rinjve (<i>Juvenile Justice</i>	24
4.8. Proçedurat për Nxënësit që kthehen nga Venddënimet e Gjykatës.....	25
PARAGRAFI 5. INICIATIVA PER REDUKTIMIN E MUNGESAVE PA ARSYE NE SHKOLLE.	25
5.1. Ndërhyrja/Masat për frekuentimin e rregullt të shkollës/Ndihma për parandalim e mungesave pa arsye (“ATIPS”) dhe Nëpunësit që merren me Prindërit e nxënësve që bëjnë mungesa pa arsye (“PTO”)	25
5.2. Programi i Eliminimit të Mungesave pa Arsye	25
5.3. Qëndrat e Mungesave pa Arsye	25
PARAGRAFI 6. POLITIKAT	25
6.1. Politika Kundër-Diskriminimit dhe Kundër-Ngacmimit/Rënies në qafë.....	25
6.2. Ankesat/Politika e Ankesave.....	26
6.3. Politika e Kontrollit të Dollape Të Nxënësve (<i>Lockers</i>).....	27
6.4. Të Dhënat e Nxënësit (<i>Student Records</i>).....	27
6.5. Konfiskimi i Bip-erave, celulareve, dhe Aparateve të tjera Telefonike	27
6.6. Politika e Shprehjes së lirë të Nxënësit	27
PARAGRAFI 7. NUMRAT E TELEFONIT ME SHPESH NE PERDORIM.....	28

PARAGRAFI 1. HYRJE

1.1. Politika e Drejtorisë Arsimore.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias (*"District"*) është e angazhuar në përpjekjet për të krijuar një mjedis të sigurtë dhe pozitiv për të gjithë nxënësit, stafin, prindërit dhe partnerët e komunitetit. Drejtoria do të punojë për të bërë të sigurtë, se të gjithë nxënësit dhe stafi arsimor janë të motivuar drejt, dhe plotësisht të vetëdijshëm për potencialet e tyre, të dedikuar për një mësim të vazhdueshëm dhe edukimin e një brezi të ri sa më produktiv dhe të aftë. Drejtoria Arsimore beson që, të gjithë fëmijët mund të mësojnë në një mjedis mësimor të sigurtë. Ajo organizon një sërë aktivitete për të dalluar, festuar dhe shpërblyer sjelljen pozitive në klasë, shkollë dhe në nivel Drejtorie.

Përveç Kodit të Sjelljes së Nxënësit (*"Code"*), Drejtoria arsimore ka politika të ndryshme që administrojnë sjelljen e nxënësve. Një kopje e kësaj politike mund të merret në këtë adresë www.phila.k12.pa.us ose Zyra e Komunikimeve (*Office of Communications*), 215-400-4040.

Zbatimi i këtij Kodi kërkon angazhimin e të gjithëve në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm mësimor për Drejtorinë tonë. Për kopje në gjuhë të tjetra përveç Anglishtes, ju lutem kontaktoni, Zyrën e Komunikimeve të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, në numrin e telefonit 215-400-4040.

1.2. Motoja jonë- Mbështetja e sjelljes pozitive

Synimi i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias është të sigurojë një mjedis mësimor sa më produktiv për çdo nxënës. Kjo kërkon nga të gjithë të kuptojnë dhe zbatojnë standardet e duhura të sjelljes pozitive, që do të çojë në krijimin e një mjedisi më produktiv në klasa. Kodi i Sjelljes së Nxënësit duhet të zbatohet me synimin drejt krijimit të një mjedisi, ku sjellja pozitive mësohet dhe përfordhet çdo ditë, dhe ku bëhen ndërhyrjet e duhura në përmbushje të nevojave të nxënësve.

Prandaj, është përgjegjësia jonë që të bëjmë të sigurtë se standardet e sjelljes mësohen dhe përfordhen në çdo shkollë dhe çdo ditë, duke shfrytëzuar një proces të gjerë mbarëshkollor të mbështetjes së sjelljes pozitive. Kjo përfshin monitorimin e kujdesshëm të progresit akademik të nxënësit duke bërë ndërhyrjet e duhura, dhe për të shmangur sjelljet e këqija, që shpesh vijnë si rrjedhojë e rezultateve jo të mira në mësim, si edhe vëmendjen e duhur ndaj mësimi dhe mjedisit. Drejtoria arsimore ka besimin se, nëpërmjet një procesi të organizuar për sigurimin e mbështetjes së duhur, shkollat do të ulin numrin e sjelljeve jo të pranueshme dhe si pasojë edhe të rekomandimeve për marrjen e masave disiplinore. Ndërhyrjet në kohën e duhur janë rezultate, kur ato funksionojnë në menyrë aktive dhe jo reaktive. Rëndësia e një sistemi eficient dhe të kuptueshëm nga të gjithë, lidhur me përfordhimin e sjelljes së duhur dhe monitorimin e progresit të nxënësit duke venë në veprim të gjitha të dhënat e nevojshme janë esenciale për suksesin e nxënësit.

1.3. Qëllimi i Kodit të Sjelljes së Nxënësit.

Drejtoria ka miratuar këtë Kod, për të mbështetur krijimin e një mjedisi të sigurtë mësimor për të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës. Qëllimi i Kodit të Sjelljes është që, të tregojë qartë normat e pranueshme të sjelljes së nxënësve. Ky Kod gjithashtu shpjegon, se cilat janë pasojat për shkeljen e këtyre normave si dhe përfordhimin më tej politikën e mostolerancën ndaj sjelljeve, të cilat rrezikojnë sigurinë në shkolla dhe/ose sjelljeve që bien ndesh me eksperiencën edukuese për nxënësit e tjerë. Drejtoria Arsimore nuk lejon ndëshkimin fizik.

Me tej ky kod parashtron procedurat disiplinore për nxënësit që e shkelin atë. Kodi ka si qëllim të jetë një kontratë ndërmjet Drejtorisë dhe nxënësve, dhe mund të ndryshohet në çdo kohë. Kodi është një mënyrë e Drejtorisë për të shpjeguar politika të caktuara të pranuar nga nxënësit.

1.4. Kufiri i Shtrirjes së Kodit. Ky kod do të zbatohet në çdo sjellje që ndodhin:

- a. në terrenet e shkollës, në çdo kohë;
- b. jashtë terrenit të shkollës, në aktivitete apo ngjarje shkollore;
- c. jashtë terrenit të shkollës, kur kjo sjellje, ka të ngjarë të: (a) shkatërrojë autoritetin e duhur të disiplinës në shkollë;(b) të rrezikojë sigurinë e Anëtarëve të Komunitetit të Shkollës; ose (c) të krijojë shqetesime për shkollën/prish orën e mësimit; dhe
- d. gjatë rrugës për në ose nga shkolla, duke përfshirë, por pa kufizuar sjelljet apo aktet në autobuzat e shkollës, furgon shkollor ose mjet tjetër transporti publik.

1.5. Politika e Barazisë për të Gjithë.

Drejtoria Arsimore vepron në përputhje me të gjitha ligjet federale, shtetërore dhe lokale, dhe siguron mundësira të njëjta për të gjithë nxënësit. Drejtoria ndalon diskriminimin ndaj pranimeve në shkollë, vlerësimeve, disiplinimeve apo ndonjë aktivitet tjetër që nisët nga raca, besimi, ngjyra, prejardhja kombëtare, feja, prejardhja familjare, mosha, gjendja civile, orientimi seksual (i njohur apo i supozuar), gjinija, gjymtimi fizik, kombësia apo nënshtetësia.

Të gjitha vendimet e Drejtorisë Arsimore do të zbatohen pa marrë parasysh kategorizimet e mësipërme.

1.6. E Drejta për Shërbime Gjuhësore

Nxënësit dhe prindërit, të cilët flasin një gjuhë tjetër nga Anglishtja kanë të drejtën e shërbimit të përkthimit gojor dhe me shkrim falas. Është detyrë e Drejtorisë Arsimore të informojë nxënësit dhe anëtarët e familjes për të drejtën e mundësisë së shërbimeve gjuhësore që ajo ofron.

Drejtoria Arsimore është e detyruar të sigurojë shërbime gjuhësore nëpërmjet një presoneli të kualifikuar në bazë të ligjit federal dhe shtetëror. Në qoftë se, kërkohen këto shërbime, Drejtoria duhet të garantojë një personel të kualifikuar.

1.7. Fjalori i Termave.

1.7.1. “Caktimi në Shkollë Alternative” (“*Alternative School Placement*”) do të thotë një shkollë ose program, që ka për qëllim përmirësimin e sjelljes së nxënësit, të frekuentimit dhe rezultateve në mësim.

1.7.2. “Rishikim i Sjelljes” (“*Behavior Performance Review*”) do të thotë një rishikim i progresit në mësim dhe përmirësimin të sjelljes së nxënësit në arsimin e rregullt (*Regular Education*).

1.7.3. “Sjellje Brutale/Frikësim dhe Kërcënim” (“*Bullying*”) do të thotë manifestim i sjelljeve të tilla, që parandalon, dekurajon, ose vë në rrezik të drejtën e arsimit të një nxënësi tjetër. Sjellja brutale përcaktohet si një sjellje e qëllimshme dhe lënduese, i kryer vazhdimisht për një periudhë kohe, karakterizuar kjo edhe nga mosbalanca mes të fortit dhe të dobrit (përsa i përket seksit, fuqisë fizike ose mendore, pranimit në shoqëri e tjera). Këto sjellje të ndaluara përfshijnë ushtrimin e dhunës, forcës, ngacmimit të përsëritur, abuzimit/sharjes, presionit, kërcënimit ndaj nxënësve, personelit të shkollës, ose vizitorëve të shkollës ose persekutimit fizik, psikologjik, apo seksual.

1.7.4. “Cyber-Bullying” do të thotë kërcënim, që kryet me anë të mjeteve elektronike, nëpërmjet e-mailit, mesazheve të çastit, mesazhve elektronike (*text messages*), komunikimit elektronik në domenin privat (*blogs*), celularëve, bi-pave, dhe websaiteve.

1.7.5. “Kodi” “Rregullore” (“*Code*”) nënkupton këtë Kod të Sjelljes së Nxënësit.

1.7.6. “Proçesi i Ndhmës së Gjithanshme për Nxënësit e Prapambetur” (“*Comprehensive Student Assistance Process or CSAP*”) do të thotë një proçes mbështetjeje e gjithanshme për nxënësit e kopshtit deri në klasën e 12^{të}, i urdhëruar nga shteti. Ky proçes mundëson identifikimin, ndërhyrjen e duhur dhe planin ndihmës për nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar ose/dhe probleme në sjellje.

1.7.7. “Ndëshkimi trupor”ose rrahja (“*Corporal Punishment*”) do të thotë ndëshkim fizik të një nxënësi për një shkelje të Kodit. Ndëshkimi trupor, nuk përfshin përdorimin e forcës nga mësuesit apo autoritetet e shkollës (1) për të shuar një rrëmujë; (2) për të marrë armët apo objekte të tjera të rrezikshme; (3) për qëllim vetëmbrojtje; ose (4) për mbrojtjen e njerëzve apo pronës.

1.7.8. “Aftësi të Kufizuara/Handikapat” (“*Disability*”) do të thotë një dëmtim fizik apo mendor ,që kryesisht kufizon një ose më shumë aktivitete kryesore etike të një individi; një lidhje të këtij dëmtimi; apo i konsideruar me këtë gjymtim; apo një gjymtim specifik si: gjymtim/paafhtësi e shumëfishtë, sëmundje mendore (*autism*), i prapambetur mendërisht, paafhtësi e të nxënësit (të mësuarit) , dëmtim i dëgjimit, dëmtim i të folurit, dëmtim i të parit, çrregullim serioz emocional, dëmtim ortopedik (i gjymtyrëve), dëmtim traumatik i trurit apo dëmtim tjetër lidhur me shëndetin.

1.7.9. “Drejtoria/Seksion i Arsimit” (“*District*”) nënkupton Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

1.7.10. “Formulari EH-21” (“*EH-21 Form*”) është një formular që përdor Drejtoria Arsimore për dokumentimin e incidenteve dhe rekomandimin për transferim disiplinuar në shkollat alternative.

1.7.11. “Përrjashtim” (“*Expulsion*”) do të thotë heqjen e një nxënësi nga shkolla për më shumë se 10 ditë për shkak se, ai/ajo e ka shkelur këtë Kod/Rregullore.

1.7.12. “Bandë” (“*Gang*”) nënkupton çdo organizatë apo grup njerëzish në veprim, të cilën mund ta identifikosh nga emri, shenja apo simboli, anëtarët e së cilës individualisht apo në grup kanë qënë apo janë të angazhuar në lloje aktivitete, që rrezikojnë apo përçajjnë sigurinë e shkollës apo të Anëtarëve të Komunitetit të shkollës.

1.7.13. “Plan Individual Edukimi” “IEP” (“*IEP*”) do të thotë mbështetja e një nxënësi me aftësi të kufizuara/handikapat, i cili kërkon një plan të detajuar ndihmës në mësim, ose shërbime specifike, veçanërisht për këtë nxënësi.

1.7.14. “Pezullim nga Mësimi brenda Shkollës” (“*In-School Suspension*”) do të thotë një masë disiplinore, që lejon nxënësin të marrë pjesë në shkollë, por e ndalon atë nga ndjekja e orës së mësimit në klasën e rregullt.

1.7.15. “Përcaktimi i Natyrës së Paafhtësisë së Nxënësit/es” (“*Manifestation Determination*”) do të thotë rishikimi i një programi special edukativ për nxënësin me paafhtësi për të përcaktuar nëse, sjellja e keqe që ai/ajo manifeston është e lidhur me këtë dëmtim (paafhtësi të nxënësit/es).

1.7.16. “Anëtar i Komunitetit të Shkollës” (“*Member of the School Community*”) nënkupton çdo nxënësi, prind, mësues, administrator, apo punonjës të Drejtorisë apo vizitorë të çdo shkolle.

1.7.17. “Rekomandim për Caktimin e Mjedisit Edukativ të Nxënësit” (“*NOREP*”). Ky rekomandim do t’i prezantohet prindit/kujdestarit të fëmijës, i cili manifeston këtë Paafhtësi, dhe do të përmbledhë rekomandimet për programin edukativ të fëmijës.

1.7.18. “Zotërim” (“*Possession*”) nënkupton kontroll fizik të pronës (qoftë e humbur, e gjetur, apo e vjedhur) të gjërave të tilla si veshje, çelësa dollapesh apo çanta dhe çdo gjë ,që ato mund të kenë brenda.

1.7.19. “Terreni i shkollës” (“*School Ground*”) nënkupton çdo pronë që zotëron apo përdor Drejtoria, apo pronë të përdorur nga çdo tregëtar, që është në kontratë me Drejtorinë Arsimore.

1.7.20. “Privilegjet në shkollë” (“*School Privileges*”) nënkupton çdo aktivitet ose program shkollor ku përfshihen, por nuk kufizohen si, ceremonia e diplomimit, ekskursionet e klasës, mbrëmjet e vallzimit, skuadrat e sportit, klubet apo pushimi i madh.

1.7.21. “Marrëveshje për Shërbime Ndhmëse” (“*Service Agreement*”) nënkupton lehtësirat që i bëhen një nxënësi/eje me paaftësi, që të lejohet të hyjë apo të përdorë mjediset e shkollës dhe të programit mësimor.

1.7.22. “Dëmtim serioz trupor” (“*Serious Bodily Injury*”) nënkupton dëmtim të trupit, i cili krijon një rrezik për vdekje apo që krijon dëmtim të përhershëm të rëndë, humbje apo dëmtim të funksionimit të ndonjë pjese ose organi të trupit.

1.7.23. “Program që synon përmirësim të Sjelljes dhe formimit të karakterit” (“*Saturday Morning Alternative Reach and Teach Program or SMART*”) nënkupton një program të gjërë, dhe të harmonizuar, që organizohet ditën e Shtunë në mëngjes. Programi SMART zhvillon aftësitë e nxënësve në formimin e karakterit të tyre dhe zgjidhjen e konfliktit, ashtu si edhe parandalimin, ndërhyrjen, identifikimin dhe shërbime të tjera ndihmëse, për problemet që lidhen me alkolin ose drogën dhe sjelljen e keqe në përgjithësi.

1.7.24. “SRC” (*School Reform Commission*) – do të thotë Komisioni e Reformës Shkollore.

1.7.25. “Pezullim” (“*Suspension*”) nënkupton heqja/kufizimi i nxënësit/es, jo me vullnet të tij/saj, nga pjesëmarrja në klasë ose në shkollë për dhjetë (10) ose më pak ditë.

1.7.26. “Hyrje pa leje” (“*Trespass*”) nënkupton hyrje në territorin e shkollës, kur është e ndaluar.

1.7.27. “Armë” (“*Weapon*”) nënkupton te gjitha, por që nuk kufizohet, si me poshte- thikat, mjete që presin, vegël prerëse, armë zjarri, pushkë gjahu, dyfek, gërshërë dhe ndonjë vegël tjetër, instrument apo objekt i përdorur apo synuar të përdoret për dëmtim fizik të ndonjë anëtari të komunitetit të shkollës. Ky përkufizim përfshin, por nuk kufizon përdorimin apo synimin për përdorim të spërkatjes me piper (*pepper spray*), skepter/topuz ose shigjetë lazeri, që sjellin dëmtime të rënda të një anëtari tjetër të komunitetit të shkollës.

PARAGRAFI 2. TE DREJTAT DHE PERGJEGJESITE E NXENESVE DHE PRINDERVE

2.1. Përgjegjësitë e Nxënësve. Të gjithë nxënësit ashtu si dhe administrata e trupi pedagogjik kanë përgjegjësi të krijojnë një mjedis të sigurtë mësimor brënda shkollës. Nxënësit kanë përgjegjësi të:

2.1.1. vijjnë në shkollë në orarin e caktuar dhe të frekuentojnë shkollën çdo ditë;

2.1.2. bëjnë përpjekje të ndërgjegjshme për detyrat e klasës dhe të shtëpisë

2.1.3. njohin dhe zbatojnë rregullat dhe normat e shkollës dhe ligjet atje ku kërkohet;

2.1.4. vishen në përputhje me Kodin e Veshjes dhe PARAGRAFI 3, Rregulli 2.

2.1.5. mos përdorin fjalë të pahijshme, të turpshme apo të pista;

2.1.6. tregojnë sjellje shumë të mira në sport gjatë pjesëmarrjes në aktivitete të lidhura me shkollën;

2.1.7. raportojnë incidente apo veprime që mund të kërcënojnë apo të përçajnë mjedisin e shkollës tek një nga nënpunësat e shkollës ose në Linjën Direkte të Drejtorisë mbi Sigurinë në shkollë @ 215-400-SAFE (7233).

2.2. Të Drejtat e Nxënësve. Nxënësit kanë të drejtën:

2.2.1. e arsimimit publik, të rregullt dhe falas prej moshës 6-21 vjeç;

2.2.2. e mos përjashtimit nga shkollat publike ose nga privilegjet e shkollës, nëse nxënësi martohet, ngelet shtatëzanë, është handikapat/me aftësi të kufizuara, plotëson kërkesat për shërbime dhe programe të arsimimit special (*special education*), ose për arsye race, gjinie, ngjyre, besimi, orientimi seksual (i njohur apo i supozuar), shprehjes së identitetit gjinor (i njohur apo i supozuar), apo origjine kombëtare;

2.2.3. të mos jetë subjekt i Ndëshkimit Fizik; dhe

2.2.4. t'i jepen procedurat disiplinore të parashtruara në Paragrafin 4.

2.2.5. Nëse Anglishtja nuk është gjuha e tyre e parë, të kërkojnë që t'u jepet asistencë përkthimi me shkrim dhe gojë për problemet që lidhen me shkollën.

2.3. Përgjegjësitë e Prindërve/Kujdestarëve. Prindërit/Kujdestarët do të kenë përgjegjësi të:

2.3.1. sigurojnë që, fëmijët e tyre të moshës 8 deri në 17 vjeç, të regjistruar në shkollat e kësaj Drejtorie, të frekuentojnë shkollën rregullisht, në orar, gjatë gjithë ditës, në përputhje me ligjet e Shtetit të Pensilvanisë. **N.q.se fëmija regjistrohet në shkollë para moshës 8 vjeç, fëmija bëhet në moshë shkollore të detyrueshme dhe duhet të vazhdojë të ndjekë shkollën rregullisht;**

2.3.2. sigurojnë se, fëmijët e tyre, nën 8 vjeç, nëse janë regjistruar në shkollë, të ndjekin shkollën rregullisht dhe në orar, në përputhje me ligjet e Shtetit të Pensilvanisë.

2.3.3. regjistrojnë fëmijën e tyre në një shkollë tjetër nga ato të Drejtorisë, n.q.se ai/ajo përjashtohet nga shkolla;

2.3.4. lajmërojnë dhe t'i japin prova dëshmie Drejtorisë, brënda 30 ditëve të përjashtimit, n.q.s ata nuk mund të gjejnë vend në një shkollë tjetër, jo të Drejtorisë Arsimore për fëmijën e tyre;

2.3.5. t'i paraqesin nëpunësve të shkollës ndonjë shqetësim apo ankim në mënyrë të qetë dhe të arsyeshme;

2.3.6. bashkëpunojnë me shkollën në çështjet akademike, probleme të disiplinës ose të tjera çështje të lidhura me këto;

2.3.7. planifikojnë kohën dhe vendin për detyrat e shtëpisë dhe të sigurojnë kontrollin e nevojshëm;

2.3.8. bisedojnë me fëmijën e tyre rreth aktiviteteve në shkollë dhe sjelljen e duhur që kërkohet prej tyre;

2.3.9. njohin rregullat e vendosura në këtë Kod dhe t'i rishikojnë ato me fëmijën; dhe

2.3.10. sigurojnë që fëmija bën vizitat shëndetësore në mënyrë periodike, siç kërkohet nga ligji.

2.4. Të drejtat e Prindërve/Kujdestarëve. Prindërit/kujdestarët kanë të drejtë të:

2.4.1 marrin një raport të rregullt zyrtar mbi progresin akademik të fëmijës;

2.4.2 kontrollojnë, bëjnë kopje, dhe kundërshtojnë pjesë ose të gjithë informacionin, që jepet në të dhënat e nxënësit sipas direktivave të duhura;

2.4.3 kërkojnë shpjegime nga mësuesi për kriterin e ndonjë note të vënë;

2.4.4 informohen menjëherë për mungesat apo vonesat nga një ose disa orë mësimi;

2.4.5 kërkojnë takim me mësuesin dhe/ose me Drejtorin/en e shkollës;

- 2.4.6** marrin shërbime përkthimi dhe/ose interpretimi me shkrim apo me gojë në lidhje me fëmijën e tyre dhe arsimimin e fëmijës;
- 2.4.7** marrin të gjithë korrespondencën në gjuhën e preferuar nga familja, nëse është ndryshe nga Anglishtja, përveç rastit kur është një gjuhë e rrallë; në këtë rast do të ofrohet një përkthim me gojë dhe drejtëpërdrejtë dhe do të jepet nga një person i stafit, i cili/e cila zotëron të dyja gjuhët;
- 2.4.8** sjellin vetë, ose t'i kërkojnë Drejtorisë të sigurojë përkthyes gjatë takimeve disiplinore, kur një prind ose nxënës nuk e ka Anglishten gjuhën e parë ose ka vështirësi të kuptueshme për të komunikuar në Anglisht;
- 2.4.9** apelojnë akte disiplinore, sikurse janë dhënë në PARAGRAFIN 4; dhe
- 2.4.10** t'u bëhen lehtësira të arsyeshme për çdo lloj Gjymtimi/Paafhtësie, në mënyrë që të marrë pjesë në edukimin e fëmijës së tyre, deri aty ku prindërit lejohen të marrin pjesë, nëse bëhet kërkesë për këto lehtësira dhe provë mjekësore.

2.5. Të Drejtat e Viktimës në Sulmet e Kryera në Shkollë.

- 2.5.1.** Çdo person i dëmtuar nga një nxënës që ka kryer shkelje të Shkallës II^{-të} të Kodit të Sjelljes, ka të drejtë të dëshmojë fakte në mbrojtje të tij/saj në seancën disiplinore të shqyrtimit të çështjes.
- 2.5.2.** Çdo viktimë e një krimi të kryer nga një Anëtar i Komunitetit të Shkollës, ka të drejtë ta hedh çështjen për ndjekje penale në Gjykatën e Krimeve ose Gjykatën e Minorenëve. Për këtë, viktima mund të nisë akuzat me Policinë e Filadelfias ose të dorëzojë një ankesë penale private. Për të bërë një ankesë penale, n.q.s shkelësi penal është një i rritur, viktima duhet të marrë në telefon në numrat 215-686-9863, 215-686-9864 ose 215-686-9865, dhe nëse shkelësi i ligjit është një minorene, viktima duhet të telefonojë në numrin 215-686-7430.
- 2.5.3.** Një viktimë mund të kontaktojë gjithashtu Avokatin e Departamentit të Arsimit për Shkollë të Sigurta me nr.telefoni 215-644-1277 ose Linjën Direkte të Drejtorisë mbi Sigurinë me nr. 215-400-SAFE.
- 2.5.4.** Një viktimë gjithashtu mund të bëjë ankesë në bazë të procedurës së Drejtorisë për ankimin e nxënësit të shpjeguar në Paragrafin 6.

PARAGRAFI 3. SHKELJET E NXENESIT DHE PASOJAT

Ky Kod i ndan këto shkelje në dy nivele: (1) Niveli **I-rë** i Shkeljeve; (2) Niveli **II-të** i Shkeljeve.

Niveli i shkeljeve dikton shkallën e masës së riedukimit, që do të imponojë Drejtoria. **Përveç shkeljeve specifike të shpjeguara më poshtë, Drejtoria ka të drejtë të disiplinojë çdo nxënës, i cili përzihet në sjellje që nuk janë thënë më poshtë, por kërcënojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqënien e të tjerëve ose cënojnë mësimin.** Masa e përshtatshme e riedukimit, sipas ligjit, është vetëm kompetencë e Drejtorisë.

Një nxënës ka të drejtën e procedurave të përcaktuara në Paragrafin 4, ku rekomandohen masat e riedukimit.

N.q.s ndonjë Anëtar i Komunitetit të Shkollës ka pyetje rreth Kodit ai/ajo duhet të kontaktojë Zyrën e Arsimit Alternativ në Tranzicion (*Office of Transition and Alternative Education*) me nr. 215-400-4220. Për kopje në gjuhë të tjera nga Anglishtja, ju lutem kontaktoni Zyrën e Komunikimeve në numrin e telefonit 215-400-4040.

3.1. Niveli I-rë i Rregullave.

- Rregulli 1.** **Ndalohet Prishja e Mësimit në Shkollë:** Nxënësit duhet të jenë të sjellshëm ndaj të gjithë Anëtarëve të Komunitetit të Shkollës dhe ndalohen të prishin rregullin e çdo lloj programi edukativ ose shkollor. Shkelja e këtij rregulli do të përfshijë, por nuk kufizohet nëse nxënësi:
- nuk i bindet udhëzimeve të drejtorit, mësuesve dhe anëtarëve të tjerë të organikës;
 - thyen rregullat e vendosura në shkollë;
 - mban ose përdor bip-er, celularë, uokmen (*walkman*) ose mjete të tjera telefonike gjatë orëve ose programeve të shkollës;
 - mban spekter, shpërndarës të piperit, ose tregues lazeri;
 - vrapon dhe/ose bën zhurmë shumë të madhe në korridor ose në godinë
 - kalon pa leje, sillen vërdallë dhe/ose nuk tregojnë dokument identifikimi të shkollës ,kur i kërkohet;
 - mungon nga mësimi pa patur ndonjë justifikim të arsyeshëm;
 - aktivizon alarmin e zjarrit, kur nuk ka asnjë kërcënim për zjarr; ose
 - vjen vonë në shkollë ose klasë.
- Rregulli 2.** **Zbatimi i Kodit të Veshjes:** Nxënësit duhet të vishen në përputhje me standartet e përshkruara më poshtë dhe ato të parashtruara në kodin e veshjes, të adoptuara nga secila shkollë, e cila vendos ngjyrat dhe modelin e përshtatshëm të rrobave, që duhet të perdore nxënësi. Një nxënës shkel këtë rregull n.q.se ai/ajo:
- nuk vesh ngjyrat e përcaktuara të uniformës;
 - nuk vesh modelin e caktuar të veshjes;
 - nuk vesh pantallonat të ngritura sa duhen në mes ose nëse nuk vë rrip;
 - vesh rroba shumë të vogla ose shumë me të mëdha nga sa është masa e nxënësit;
 - vesh bluza me numër shumë më të madh nga masa, bluza që tregojnë muskulin ose bluza me tiranda;
 - ekspozon të brendshmet ose vesh veshje me rripa të holla ose veshje të tejdukshme;
 - vesh kapuçë në formë çorapeje, shami të larme, rripa koke ose kasketa.
- Rregulli 3.** **Ndalohet mbajta e Ngjyrave dhe Simboleve të Bandave:** Nxënësit nuk duhet të veshin rroba me ngjyra/simbole të ndonjë bande. Një nxënës thyen këtë rregull n.q.se ai/ajo:
- vesh rroba me ngjyra të një bande me qëllim që të tregojë besnikeri ndaj kësaj bande;
 - vesh gjëra sportive me qëllim që të tregojë besnikeri ndaj bandës;
 - vesh çdo lloj veshje që përmban simbolin e bandës.
- Rregulli 4.** **Ndalohet Fjalori Banal/Fyes:** Nxënësi nuk duhet të përdorë fjalor fyes. Një nxënës shkel këtë rregull n.q.se ai ose ajo:
- shan ose përdorë fjale vulgare, të turpshme dhe fyese; ose
 - dërgon ose përcjell ndonjë mesazh fyes, me orientim seksual ose kërcënues, fotografi ose simbole nga çdo burim, tek ndonjë Anëtar tjetër i Komunitetit të Shkollës.

- Rregulli 5.** **Mandat/Rregullore për Ndërgjegjshmëri Akademike:** Nxënësit mendohet të kenë shkallën më të lartë të ndershmërisë në punën e tyre. Një nxënës thyen këtë rregull n.q.s. ai ose ajo mashtron, kopjon punën e një tjetri, bën plagjiaturë (vjedh ide) punën e një tjetri, ose falsifikon një shënim nga dikush tjetër. Vjedhja e testeve të standartizuara, ndryshimi në nota dhe/ose i të dhënave të mungesave do të konsiderohet një shkelje e Shkallës II-të.
- Rregulli 6.** **Ndalohet Abuzimi me Kompjuterin ose i Privilegjeve të Internetit:** Nxënësit duhet të respektojnë privilegjin që i jepet të përdori kompjuterin. Një nxënës shkel këtë rregull n.q.s ai ose ajo:
- i jep fjalëkalimin (*password*) e tij/saj një personi tjetër ose përdorë të dhënat e një tjetri ;
 - shkarkimi (*download*) ilegalisht i materialeve që kanë të drejtën e autorit nga interneti;
 - futet në faqe të internetit që përmbajnë material seksual;
 - dëmton ose shkatërron të dhënat e një studenti apo një personi tjetër në internet ose në rrjete të tjera;
 - krijon, shkarkon (*download*), ose transmeton viruse kompjuteri; ose
 - thyen ndonjë nga rregullat që përmban Politika e Drejtorisë Arsimore (*School District's Acceptable Use Policy*), e cila mund të gjendet në adresën www.phila.k12.pa.us.
- Rregulli 7.** **Ndalohet Vjedhja dhe Shkatërrimi i Pronës:** Nxënësit duhet të respektojnë pronën dhe nuk duhet ta dëmtojnë, shkatërrojnë apo ta vjedhin atë. Një nxënës thyen këtë rregull, n.q.s. ai/ajo shkakton dëm ose vjedhje të pronës në shumën që nuk e kalon \$150 kur:
- lyen dhe vizaton me grafit në objektet e pronës;
 - dëmton ose tenton të shkaktojë dëme të pronës;
 - vjedh ose tenton të vjedh gjëra që janë pronë e shkollës ose vjedh në ndonjë aktivitet të sponsorizuar nga shkolla.
- Rregulli 8.** **Ndalohet Kumari:** Nxënësit nuk duhet të hedhin baste për përfitime personale.
- Rregulli 9.** **Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit nga Pakujdesia:** Një nxënës nuk duhet të veprojë në mënyrë të tillë, që mund të rrezikojë dëmtimin e shëndetit, sigurisë, ose mirëqënies së çdo Anëtarit të Komunitetit të Shkollës.
- Rregulli 10.** **Ndalohen Kërcënimet:** Një nxënës nuk duhet të kërcënojë direkt ose indirekt asnjë Anëtar të Komunitetit të Shkollës dhe ta frikësojë me plagosje, lëndim, apo tallje. Kërcënimet serioze për jetën ose mirëqënien, do të konsiderohen shkelje e Shkallës II-të. (*Shiko Rregullin 18, Ndalimi i Frikësimit dhe Kërcënimeve serioze*).
- Rregulli 11.** **Ndalohen Zëniet/Rrahjet:** Nxënësi duhet t'i shmanget konfrontimeve të dyanshme, që përfshijnë kontakte fizike me çdo Anëtar të Komunitetit të Shkollës.
- Rregulli 12.** **Ndalohen Dhuna/Goditjet e lehta:** Nxënësit nuk duhet të shkaktojnë apo tentojnë t'i shkaktojnë plagosje në trup asnjë nxënësi tjetër apo vizitori. Veprimet, që do të rezultojnë në dëmtime serioze të trupit dhe që kërkojnë ndërhyrjen e mjekut do të konsiderohen një shkelje e Shkallës II (*Shiko Rregullin 23, ndalim i dhunës seksuale*).
- Rregulli 13.** **Ndalohen Veshjet dekolte dhe Prekjet e Pahijshe:** Nxënësit nuk duhet t'i a zbulojnë organet gjenitale të tyre një anëtar tjetër të komunitetit të shkollës ose të prekë organet gjenitale të një tjetri. Ky rregull përfshin edhe kontaktet e rastësishme, kur nxënësi nuk ka qëllim dashakeqës ose nuk arsyeton të kuptojë pasojat e sjelljes së tij/saj. Shkelje e përsëritur e këtij rregulli do të

konsiderohet një shkelje e Shkallës II-të (*shiko rregullin 21, ndalim i dhunës seksuale*). Shkelje e këtij rregulli nuk përfshin:

- a. Dhunën seksuale;
- b. Ngacmimet seksuale; ose
- c. Aktet seksuale.

Rregulli 14. Ndalohen Produktet e Duhanit dhe e Mjeteve që lidhen me të: Asnjë nxënës nuk duhet të mbajë ose përdorë produkte të duhanit si çakmak, shkrepse, letër duhani, çibuk, ose mjete të tjera si këto.

Rregulli 15. Ndalohen Droga dhe Pijet Alkolike: Nxënësit nuk duhet të mbajnë, të përdorin ose të jenë nën influencën e drogës, pijeve alkolike apo ilaçeve të pa autorizuara, me apo pa recetë.

Nxënësi nuk e thyen këtë rregull, n.q.s ai/ajo mban një ilaç të dhënë me recetë nga një doktor i licencuar dhe që është e paketuar, siç është dhënë nga farmacisti, ku tregohet emri i nxënësit ose një ilaç pa recetë, që nxënësi e ka me lejen e prindit apo doktorit. Nxënësi duhet të mbajë vetëm dozën e nevojshme të ilacit për përdorim ditor në shkollë.

3.2. Niveli II-të i Rregullave.

Rregulli 16. Thyerje të Përsëritura të Kodit: Nxënësit nuk lejohen të bëjnë disa thyerje të përsëritura të Nivelit I-rë, Rregulli 1, 3, 5-14. Ky rregull nuk do të konsiderohet i thyer, n.q.s shkolla nuk arrin të marrë masat dhe të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për secilën nga këto shkelje. Nxënësit nuk mund të pezullohen nga mësimi për thyerje të përsëritshme të Kodit të Sjelljes së Nxënësit. Ju lutemi, referohuni rregullit, që lidhet me këtë sjellje, ku përshkruhet thyerja e rregullores, se sa Rregullit 16, për të vendosur kodin e pezullimit.

Rregulli 17. Ndalohet Shkatërrimi dhe Vjedhja e Pronës: Nxënësit duhet të respektojnë çdo gjë që ka të bëjë me pronën dhe nuk lejohet ta dëmtojnë atë, shkatërojnë ose ta vjedhin. Nxënësi shkel rregullin n.q.s ai/ajo dëmton ose vjedh pronën në një shumë prej \$150 ose më tepër, kur:

- a. Iyën me bojë apo vizaton me grafit objekte/pronë të shkollës;
- b. dëmton ose tenton të dëmtojë pronën;
- c. vjedh apo tenton të vjedh pronën.

Rregulli 18. Ndalohen Frikësimet, Brutaliteti dhe Kërcënimet Serioze: Nxënësit ndalohen të frikësojnë ose trëmbin Anëtarë të Komunitetit të Shkollës. Nxënësi shkel këtë rregull n.q.s ai ose ajo, duke përdorur mjete fizike, psikologjike, me shkrim ose me gojë, vepron në mënyrë të vullnetshme me synimin për të dëmtuar ose poshtëruar një tjetër anëtar të komunitetit. Kjo shkelje e rregullit do të përfshijë, por nuk do kufizohet nga goditjet:

- a. Fizike: si goditjet, shkelmimet, shtytjet, nxitja e një personi tjetër për të dëmtuar dikë;
- b. Gojore: mospërfilljet raciale, fyerjet, talljet, thumbimet, ngacmimet seksuale verbale, shpifjet, përhapja e thashethemeve; ose
- c. Jo-Gojore: kërcënimet, gjestet e turpshme, izolimet, përjashtimet, ndjekjet, ngacmimet me anë të internetit (cyber bullying-ngacmime që kryhen me anë të mjeteve elektronike si e-mail, mesazheve, mesazheve me celular, telefon celular, telefon, bi-pave ose me anë të websaiteve në internet).

- Rregulli 19. Ndalohen Ngacmimet seksuale/Kërcënimet (Harassment):** Nxënësit ndalohen të shkelin Politikën e Drejtorisë Arsimore Kundër-Ngacmimeve (*Anti-Harassment Policy of the District*), që mund ta lexoni në internet në websaitin www.phila.k12.pa.us. Nxënësi thyen këtë rregullore nëse, ai ose ajo kërkon nga të tjerët favore seksuale ose ngacmon seksualisht, kërcënon, frikëson ose mbjell një situatë armiqësie në shkollë për arsye të dallimeve përsa i përket gjinisë, racës, ngjyrës, orientimit seksual (të njohur ose të marrë me mend), origjinës kombëtare, fesë, paftësisë mendore/fizike, gjëndjes shoqërore/ekonomike dhe/ose besimit politik.
- Rregulli 20. Ndalohen Aktet Seksuale me Dëshirë:** Nxënësit ndalohen të angazhohen në veprime seksuale me dëshirë (të çdo lloji, orale ose kryerjen e marrdhënieve seksuale), në terrenet e shkollës ose në ndonjë aktivitet të sponsorizuar nga shkolla.
- Rregulli 21. Ndalohen Sulmet Seksuale me Forcë:** Nxënësit ndalohen të detyrojnë apo të përpiqen të detyrojnë një Anëtar tjetër të Komunitetit të Shkollës të kryejë mardhënie seksuale me forcë. Për pasojë të këtij rregulli, aktet seksuale përfshijnë, por nuk kufizohen nga:
- Kryerja e mardhënieve seksuale (*intercourse*)
 - seks oral
 - prekje të pjesëve intime seksuale; ose
 - seks i simuluar
- Rregulli 22. Ndalohet Përdorimi i Dhunës ndaj Personelit të Shkollës:** Nxënësit ndalohen t'i shkaktojnë ose të përpiqen të shkaktojnë me dashje, plagosje ose lëndim ndonjë punonjësi të shkollës.
- Rregulli 23. Ndalohet Dhuna/Goditjet e Rrezikshme:** Nxënësit ndalohen të shkaktojnë ose të kërcënojnë për plagosje fizike të një nxënësi tjetër ose vizitori të shkollës, duke vënë në rrezik jetën, ose të bëjnë kërcënime me armë.
- Rregulli 24. Ndalohet Grabitja:** Nxënësit ndalohen të përdorin apo përpiqen të përdorin forcën për të vjedhur ose thjesht të vjedhin pronën e një Anëtari tjetër të Komunitetit të Shkollës.
- Rregulli 25. Ndalohet Mbajta e Armëve:** Nxënësit ndalohen të mbajnë çdo lloj arme, ashtu siç përcaktohet në fjalorin e këtij Kodi. Nxënësi shkel këtë rregull edhe në rast se, ai nuk ka për qëllim ta përdorë atë si armë.
- Rregulli 26. Ndalohet Shpërndarja e Drogës ose Alkoholit:** Nxënësit ndalohen të shesin apo shpërndajnë çdo lloj droge, alkoli ose ilaçi me/pa recetë, ose të mbajnë artikuj të tillë, edhe pse mund të dëshmojnë se ato janë ose jo për shpërndarje apo për përdorim personal.
- Rregulli 27. Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit:** Nxënësit ndalohen të përfshihen, ose përpiqen të implikohen në ndonjë sjellje që rrezikon shëndetin, sigurinë ose mirëqënien e çdo Anëtari të Komunitetit të Shkollës. Një shkelje e këtij rregulli do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në akte si:
- vënien e zjarrit në territorin e shkollës;
 - hakmarrjen ndaj një Anëtari të Komunitetit të Shkollës, kur ky i fundit merr pjesë në ndonjë hetim, ose është duke ndjekur ndonjë çështje disiplinore ose akademike.
 - aktivizimin e alarmit të zjarrit kur s'ka asnjë rrezik për zjarr dhe kur departamenti i zjarrit vjen për ndihmë ose shkolla boshatiset nga nxënësit
 - kërcënimin, vendosjen apo përdorimin e bombave apo mjeteve eksplozive.

3.3 Proçes i Ndhmës së Gjithanshme të Nxënësit (The Comprehensive Student Assistance Process, CSAP): Një sistem i gjithanshëm ndërhyrjesh dhe masash në drejtim të zvogëlimit të pengesave, që bëhen shkak i prapambetjes në mësim.

Proçesi i Ndhmës së Gjithanshme të Nxënësit (CSAP) i Drejtorisë Arsimore është një proçes bashkëpunues, që kalon në tre faza (*three-tiered*), ku shkollat identifikojnë barrierat në drejtim të të mësuarit dhe ndërhyrjet që bëhen për t'i kapërcyer këto pengesa, me anë të ndihmës së dyanshme, brënda nga personeli mësimor në shkollë (*school-based*) dhe burimet ndihmëse nga jashtë shkollës si psh. komuniteti (*community-based*). Kyçi në këtë proçes është puna në klasë, ku mësuesi i klasës analizon pikat e forta dhe nevojat e nxënësve dhe përshtat metodat e mësimdhënies dhe ato të mjedisit në klasë, për krijimin e kushteve optimale për mësim.

Proçesi i ndihmës së gjithanshme në nivel shkolle (School-wide CSAP)

Çdo proçes ndihme duhet të fillojë me ndërtimin e një rrjeti mbështetës për nxënësin dhe personelin mësimor, që do të çojë në krijimin e një mjedisi produktiv për mësim. Në nivel shkolle, elementët që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të tillë, përfshijnë veprimtarite për fitimin e aftësive ndërmjet personelit mësimor dhe nxënësve, angazhimin e familjeve si partnerë në proçesim edukativ, një plan të qartë menaxhimi të problemeve që mund të manifestohen në sjelljet e nxënësve, të cilat përcaktohen qartë dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme, si dhe marrjen e vendimeve bazuar në analizat e bëra.

Faza e parë e CSAP (CSAP Tier I):

Faza e I^{te} e ndërhyrjes synon të adresojë nevojat e grupit të nxënësve, të cilët manifestojnë të njëjtat probleme dhe pengesa në mësim. Në këtë fazë, mësuesit që japin mësim në të njëjtin vit, takohen rregullisht për të identifikuar dhe zbatuar strategjitë për secilën klasë. Drejtuesi i grupit ndihmon në përgatitjen e mbledhjeve të Fazës së I^{te}.

Faza e dytë e CSAP (CSAP Tier II):

Ka raste kur nxënës të veçantë, mund të manifestojnë probleme në mësim, që nuk janë të njëjta me ato të të tjerëve. Faza e II^{te} synon të sigurojë mbështetje me objektiv dhe mbështetje individuale për secilin nxënës. Në Fazën e II^{te}, një bërthamë e ekipit, e përbërë nga profesionistë me eksperiencë (mësues, mësues psikolog, dhe/ose infermiere) bashkë me prindër/kujdestarë të fëmijës mbledhen në një takim të planifikuar nga mësuesi psikolog i shkollës. Sëbashku, ky ekip zhvillon një plan masash/ndërhyrjesh në ato fusha, që ka nevojë nxënësi dhe/ose familja. Ky plan mund të përfshijë të dyja, mbështetjen brenda shkollës dhe atë të komunitetit, dhe gjithashtu ekipi mund të përfshijë në grupin mbështetës edhe anëtarë të tjerë ndihmës (psikologun e shkollës, personel të agjensive) sipas nevojave.

Faza e tretë e CSAP (CSAP Tier III):

Në fazën e III^{te}, fokusi kryesor qëndron në bërjen e një vlerësimi mbi ndryshimin e shkollës, kur fëmija vazhdon akoma të mos ketë sukses, megjithë ndërhyrjet dhe masat e marra. Ky ndryshim i caktimit në shkollë tjetër mund të bëhet në drejtim të përmirësimit të rezultateve të fëmijës në mësim dhe sjellje. Anëtarët e ekipit, dokumentacioni, dhe vendosja e kufirit kohor drejtohen dhe bëhen nga proçedura, që janë vendosur nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias dhe Shteti i Pensilvanisë.

3.4 Ndërhyrjet/Masat e Duhura në rastet e Shkeljes së Kodit, për Nxënësit e Kopshtit deri në Klasën e 4^{ter} (K-4)

Tabelat e mëposhtëme ju japin një listë të ndërhyrjeve/masave të duhura, të cilat mund të përdoren vetëm ose të kombinuara në përgjigje të një ofeze të vetme. Për shembull, për një shkelje të vetme të Rregullit 1, një nxënësi mund t'i kërkohet të shkruajë/raportoje (*journal entry*) dhe të kërkojë falje me shkrim, takim me prindin e tij/saj dhe t'i caktohet një kujdestar nga nxënës më të rritur. **Drejtori i shkollës mund të përcaktojë të tjera masa që atij mund t'i duken të përshtatshme, të cilat nuk janë përshkruar në këtë tabelë.**

Ju lutem, mbani në vëmendje se, për nxënësit, të cilët manifestojnë përsëritje të shkeljes së kodit të sjelljes kërkohet ndërhyrje individuale; për këtë, nxënësit me tre (3) ose më shumë pezullime nga mesimi do të referohen për në procesin CSAP, krijimin e planit të ndërhyrjes, Faza e II (individuale), brenda 10 ditëve të pezullimit të tretë, që ka marrë nxënësi.

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet Klasat K-4	
Rregulli	Ndërhyrjet / Masat
<p>Rregulli 1: Ndalohet Prishja e orës së Mësimit në Shkollë. (<i>Prohibition of Disruption of School</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Bëhet punë edukative/krijuese (d.m.th nxënësi shkruan për këtë shkelje si edhe pasojat e saj; prindi e firmos. • Udhëzohet nxënësi të kërkojë ndjesë me gojë ose me shkrim atyre anëtarëve të komunitetit që janë prekur në këtë ofezë (anëtarëve të klasës osë të shkollës) • Bëhen takime me nxënës/prindër dhe mësues. • Caktohet një shok klase ose një mentor më i rritur si këshillues (nëse është e mundshme). • Me anë të CSAP, nxënësi referohet tek specialisti për konsultë ose kërkohet mbështetje nga qendra të lidhura me shkollën, të cilat merren me problemet e sjelljes (nëse është e mundshme; kërkohet miratimi i prindit). • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet e përshtatshme) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës (shih fjalorin/<i>glossary</i>) • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku është e mundshme) • Nxënësi merr pezullim nga mesimi brënda shkollës • Nxënësi caktohet në program edukimi- SMART • Nxënësi pezullohet nga mesimi (ky rregull mund të ushtrohet pasi shkolla i ka rezauruar të gjitha ndërhyrjet e thëna më lart).
<p><i>Shënim:</i> Nëse, nxënësi vjen me vonesë në shkollë ose në klasë, ai mund të mos lejohet të ndjekë mësimin e asaj ore në të cilin ai është me vonesë. Nxënësit nuk dërgohen në shtëpi për vonesë. Nxënësit nuk mund të pezullohen (suspended) për lënien e orës së mësimit, ardhje me vonesë, ose shmangjes së shkollës. Nxënësit, të cilët vijnë me vonesë ose mungojnë në mënyrë të vazhdueshme duhet të referohen për CSAP, për fillimin e planeve të ndërhyrjes të Fazës I^{re} (në grup) dhe Fazës II^{re} (individuale).</p>	
<p>Rregulli 2: Zbatimi i Kodit të Veshjes/uniformës shkollore (<i>Compliance with the Dress Code</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Pajiset nxënësi me uniformën e shkollës nga garderoba e shkolles për atë ditë. • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe mësues • Pezullohet nxënësi nga Privilegjet e Shkollës • Nxënësi merr Pezullim nga mesimi brënda në Shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART
<p>Rregulli 3: Ndalohet Mbajtja e Ngjyrave dhe Simboleve të Bandave. (<i>Prohibition of Gang Colors/Symbols</i>) (shih fjalorin)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Pajiset nxënësi me uniformë nga garderoba e shkolles për atë ditë. • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe mësues • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi referohet në organizatën që merret me problemet e komunitetit • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës. • Nxënësi pezullohet nga shkolla (mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhyrjet e thëna më lart).

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhryjet
Klasat K-4

Rregulli	Ndërhryjet / Masat
<p>Rregulli 4: Ndalohet Fjalori Banal/Fyes <i>(Prohibition of Offensive Language)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Merren masa me karakter edukues dhe krijues (d.m.th. nxënësi përshkruan me shkrim ofezën dhe pasojat e saj; prindi e firmos) • Nxënësi udhëzohet t'u kërkoje falje me gojë ose me shkrim personave të komunitetit (në klasë apo në shkollë) që janë prekur nga kjo ofezë. • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe mësues • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku të shihet e përshtatshme) • Me anë të CSAP, nxënësi referohet tek specialisti për konsultë ose kërkohet mbështetje nga qendra të lidhura me shkollën, të cilat merren me problemet e sjelljes (nëse është e mundshme; Kërkohet miratimi i prindit). • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës. • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku është e mundshme) • Nxënësi caktohet për programin SMART • Nxënësi merr pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi pezullohet nga shkolla (mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhryjet e thëna më sipër)
<p>Rregulli 5: Mandat/Rregullore e Ndërshëmrisë Akademike/Ndalohet kopja <i>(Mandate of Academic Honesty)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi ta ribëjë testin ose të ribëjë detyrën dhe të shkruaje një raport mbi pasojat e veprimit; prindi e firmos. • Përdoret literaturë edukuese, që flet për ndershmërinë në mësim ose ndershmërinë në përgjithësi. • Nxënësi udhëzohet të kërkojë falje me gojë ose me shkrim personave të Komunitetit të prekur në këtë fyerje • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe mësues • Pezullohet nxënësi nga privilegjet e shkollës • Nxënësi merr pezullim nga mësimi brënda shkollës • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kjo mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhryjet e mësipërme)
<p>Rregulli 6: Ndalohet Abuzimi me Kompjuterin dhe Privilegjeve të Internetit <i>(Prohibition of Abuse of Computer & Internet Privileges)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Merren masa me karakter edukues dhe krijues, (d.m.th. nxënësi shkruan rreth kësaj shkelje dhe pasojave prej saj; e firmos prindi) • Organizohet takim me prindin • I hiqet nxënësit privilegji i kompjuterit dhe internetit për një ditë • I hiqet nxënësit privilegji i kompjuterit dhe internetit për 5 ditë • Nxënësit i hiqet përfundimisht privilegji i kompjuterit dhe internetit • Nxënësi caktohet në programin SMART
<p>Rregulli 7: Ndalohet Shkatërimi i Pronës <i>(Prohibition of Destruction of Property)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi udhëzohet të pastrojë (në se janë zhgarravina) dhe t'i shkruaje një letër ndjese viktimës dhe drejtorit; prindi e firmos • Organizohet takim nxënës/prindër dhe mësues • Kërkohet dëmshpërblim, ku është e mundshme • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në Programin SMART • Nxënësi merr pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur dëmi është i madh pezullimi nga shkolla mund të jetë ndërhryja e parë e përshtatshme)

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat K-4

Rregulli	Ndërhyrjet / Masat
<p>Rregulli 8: Ndalohet Kumari (<i>Prohibition of Gambling</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe mësues • Kërkohet dëmshpërblim, ku është e mundshme • Nxënësi udhëzohet të shkruajë mbi efektet e kumarit në shoqëri • Nxënësit i jepet dënim (<i>detention</i>, që mund të jenë të llojeve të ndryshme, si psh. heqja e të drejtës për pushim, qëndrim pas mësimit e të tjera) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur dëmi është i madh, pezullimi nga shkolla mund të jetë ndërhyrja e parë e përshtatshme).
<p>Rregulli 9: Ndalohet Rrezikimi i jetës së Personit nga Pakujdesia (<i>Prohibition of Reckless Endangerment</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi t'i kërkojë falje me shkrim viktimës, personelit të shkollës, drejtorit; prindi e firmos. • Krijohet mundësia për të bashkëbiseduar me të gjithë klasën mbi problemet e Sigurisë në shkollë; Nxënësit krijojnë postera me temë mbi sigurinë në shkollë • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe mësues • Nxënësit i caktohet një shok klase si ndihmës/këshilltar (<i>buddy or mentor</i>) • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet ë përshtatshme) • Nxënësit pezullohet nga Privilegjet e Shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në klasë tjetër (ku shihet e përshtatshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla
<p>Rregulli 10: Ndalohen Kërcënimet (<i>Prohibition of Threats</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi udhëzohet të shkruajë një letër ku ai i kërkon ndjesë viktimës, personelit mësues dhe drejtorit; prindi e firmos atë • Shfrytëzoni rastin të bëni një bisedë me nxënësit, ku të flitet për kërcënimet dhe se çfarë ndjenje evokojnë ato. • Organizohet takim me nxënësin/prindin dhe personelin mësues dhe nxënësit i caktohet një shok klase si ndihmës/këshilltar (<i>buddy ose mentor</i>) • Nxënësi caktohet përkohësisht në një klasë tjetër (ku shihet e përshtatshme) • Nxënësit pezullohet nga Privilegjet e Shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në klasë tjetër (ku shihet e përshtatshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga mësimi
<p>Rregulli 11: Ndalohen Zëniet/Rrahjet (<i>Prohibition of Fighting</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi udhëzohet të shkruajë një letër ku i kërkon ndjesë viktimës (personit të fyer), personelit mësues, dhe drejtorit; prindi e firmos • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe personelin mësues dhe nxënësit i caktohet një shok klase si ndihmës/këshilltar (<i>buddy ose mentor</i>) • Nxënësit futet në programin “zgjdhja e konfliktit” ose nxënësi referohet në programin “Si të kontrollojmë emocionet”(ku shihet e mundshme) • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet e mundshme) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku shihet e mundshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë për atë ditë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat K-4

Rregulli	Ndërhyrjet / Masat
<p>Rregulli 12: Ndalohet Dhuna/Goditjet e lehta (<i>Prohibition of Simple Assault</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi udhëzohet të shkruajë një letër ku i kërkon ndjesë viktimës (personit të fyer), personelit mësimor, dhe drejtorit; prindi e firmos • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe personel mësimor dhe nxënësit i caktohet një shok klase si ndihmës/këshilltar më i rritur (ku shihet e mundshme) • Nxënësit në programin “zgjidhja e konfliktit” ose nxënësi referohet në programin “Si të kontrollojmë emocionet” • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet e mundshme) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku shihet e mundshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brenda në shkollë për atë ditë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla
<p>Rregulli 13: Ndalohen Veshjet dekolte dhe Prekjet e Pahijshme (<i>Prohibition of Indecent Exposure and Inappropriate Touching</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin dhe nxënësi u referohet shërbimeve mbështetëse të familjes • Nxënësi udhëzohet të shkruajë një letër ku i kërkon ndjesë viktimës (personit të fyer), personelit mësimor, dhe drejtorit; prindi e firmos • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe personelin mësimor dhe nxënësit i caktohet një shok klase si ndihmës/këshilltar më i rritur (ku shihet e mundshme) • Nxënësi referohet në programin “C&E (ku shihet e mundshme) • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet e mundshme) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku shihet e mundshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brenda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla
<p>Rregulli 14: Ndalohen Produktet e Duhanit (<i>Prohibition of Tobacco Products</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Konfiskohet produkti • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi udhëzohet të shkruajë rreth përdorimit dhe abuzimit me produktet e duhanit • Krijoni mundësinë e organizimit të një ore mësimi me temë “Si të bëjmë një jetë të shëndetshme” • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe personelin mësimor • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brenda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla
<p>Rregulli 15: Ndalohet Droga dhe Alkoli</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Konfiskohet produkti; dhe • Diskutohet problemi me nxënësin • Nxënësi referohet në programin C&E (ku shihet e mundshme) nëpërmjet CSAP-it • Nxënësi udhëzohet të shkruajë rreth përdorimit dhe abuzimit me Drogën dhe Alkolin • Nxënësit i jepet dënim (<i>detention</i>) brenda në shkollë • Nxënësi referohet në programin e trajtimit të problemeve të drogës • Organizohet takim me nxënës/prindër dhe personel mësimor • Nxënësi rekomandohet në Programin Ndihmës së Gjithanshme të Nxënësit, Faza e II-të (<i>CSAP Tier II</i>) dhe një vlerësim të situatës rreth problemit të Drogës dhe Alkolit (kërkohet miratimi i prindit) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brenda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhryjet Klasat K-4	
Rregullat	Ndërhryjet/Masat
Rregulli 16: Thyerje të Përsëritura të Rregullave të Kodit (<i>Repeat Violations of the Code</i>)	Nëse shkolla ka siguruar dhe dokumentuar të gjitha masat e duhura, përfishirë këtu edhe procesin CSAP, Faza e II ^{të} (<i>Tier II</i>), nxënësi duhet të rekomandohet për transferim disiplinor, duke përdorur formën EH21.
Rregulli 17: Ndalohet Shkatërimi i Pronës	Nxënësi pezullohet, caktohet në programin SMART dhe rekomandohet për transferim disiplinor në një shkollë tjetër, në një shkollë alternative, ose merr përjashtim duke përdorur formën EH-21 (shiko pikën 1.5.9. tek Fjalori i termave) Për thyerje të pikave të rregullores, që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, nxënësit do t'u referohen agjensive të shërbimeve mbështetëse për familjen.
Rregulli 18: Ndalohen Frikësimet, brutaliteti, Ngacmimet me anë të internetit (<i>bullying, Cyber-bullying</i>)	
Rregulli 19: Ndalohen Ngacmimet Seksuale, Kërcënimet	
Rregulli 20: Ndalohen Aktet Seksuale me Dashje	
Rregulli 21: Ndalohen Dhuna Seksuale	
Rregulli 22: Ndalohet Dhuna ndaj Personelit të shkollës	
Rregulli 23: Ndalohen Dhuna/Goditjet e Rënda	
Rregulli 24: Ndalohet Grabitja	
Rregulli 25: Ndalohet Mbajtja e Armëve	
Rregulli 26: Ndalohet Shpërndarja e Drogës ose Alkollit	
Rregulli 27: Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit	

3.5. Ndërhryjet/Masat e Duhura ndaj Dhunimit të Kodit për Nxënësit nga Klasat 5-12.

Tabelat e mëposhtme ju paraqesin ndërhryjet/masat e duhura që mund të përdoren vetëm ose të kombinuara në përgjigje të një ofeze të vetme. Për shembull, për një shkelje të vetme të Rregullit 1, një Nxënësi mund t'i kërkohet takim me prindin e tij/saj, të kërkojë falje me shkrim dhe të kryejë dënimin (*detention, i cili mund të jetë i formave të ndryshme në varësi të shkollës, si qëndrim pas mësimit, heqja e të drejtës për pushim të madh*). **Drejtori i shkollës mund të përcaktojë të tjera masa që atij i duken të përshtatshme, të cilat nuk janë përshkruar në këtë tabelë.**

Ju lutemi, mbani në vëmendje se, për nxënësit, të cilët manifestojnë përsëritje të shkeljes së kodit të sjelljes kërkohet ndërhryje individuale; për këtë, nxënësit me tre (3) ose më shumë pezullime nga mësimi do të referohen për në procesin CSAP, krijimin e planit të ndërhryjes, Faza e II (individuale), brenda 10 ditëve të pezullimit të tretë, që ka marrë nxënësi.

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat 5-12

Rregullat	Ndërhyrjet / Masat
<p>Rregulli 1: Ndalohet Prishja e orës së Mësimi në Shkollë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Organizohet takim me nxënës/prind dhe personelin mësimor • Udhëzohet nxënësi të kërkojë ndjesë me gojë ose me shkrim atyre anëtarëve të komunitetit të cilët janë prekur në këtë ofezë. • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet e përshtatëshme) • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>) (Ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin-Shërbim për Komunitetin (<i>Community Service</i>) • Nxënësi raporton çdo ditë (<i>daily report</i>) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku shihet e përshtatëshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brenda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhyrjet e thëna më sipër përveç rasteve ekstreme. Kur nxënësi është pezulluar për një ofezë për herë të parë, ai referohet për CSAP, shih më lart)
<p>Rregulli 2: Zbatim i Kodit të Veshjes/uniformës shkollore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet problemi me nxënësin • Pajiset nxënësi me uniformë nga garderoba e shkolles për atë ditë • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>) (ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin- Shërbim për Komunitetin • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brenda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART
<p>Rregulli 3: Ndalohet Mbajtja e Ngjyrave dhe Simboleve të Bandave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet problemi me nxënësin • Pajiset nxënësi me uniformë nga garderoba e shkolles për atë ditë • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>) (ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin- Shërbim për Komunitetin • Nxënësi referohet në organizatat që punojnë për problemet e Komunitetit • Nxënësi duhet të raportojë çdo ditë • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhyrjet e thëna më sipër përveç rasteve ekstreme. Kur nxënësi është pezulluar për një ofezë për herë të parë, ai referohet për CSAP)

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat 5-12

Rregullat	Ndërhyrjet / Masat
Rregulli 4: Ndalohet Përdorimi i Fjalorit banal	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Udhëzohet nxënësi të kërkojë ndjesë me gojë ose me shkrim atyre anëtarëve të komunitetit të cilët janë prekur në këtë ofezë. • Nxënësi caktohet përkohësisht në klasë tjetër (ku shihet e përshtatëshme) • Nxënësi referohet për në Gjygin e Adoleshentëve (<i>Teen Court</i>) (ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin- Shërbim për Komunitetin (ku shihet e mundshme) • Nxënësi duhet të raportojë çdo ditë (<i>Daily Report</i>) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet përfundimisht në një klasë tjetër (ku shihet e përshtatëshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhyrjet e thëna më sipër, përveç rasteve ekstreme. Kur nxënësi është pezulluar për një ofezë për herë të parë, ai referohet për CSAP)
Rregulli 5: Ndershmëria Akademike (Ndalohet kopja)	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin (<i>detention</i>) • Udhëzohet nxënësi ta ribëje testin ose të ribëje detyrën dhe të shkruajë një raport mbi pasojat e veprimit; prindi e firmos • Udhëzohet nxënësi të kërkojë ndjesë me gojë ose me shkrim atyre anëtarëve të komunitetit të cilët janë prekur në këtë ofezë. • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi referohet për në Gjygin e Adoleshentëve (<i>Teen Court</i>) (ku shihet e mundshme) • Nxënësi duhet të raportojë çdo ditë (<i>Daily Report</i>) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi pezullohet nga shkolla (mund të ushtrohet vetëm pasi shkolla i ka ezauruar të gjitha ndërhyrjet e thëna më sipër)
Rregulli 6: Ndalohet Abuzimi me Kompjuterin dhe Privilegjeve të Internetit	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi referohet për në Gjygin e Adoleshentëve (<i>Teen Court</i>) (Ku shihet e mundshme) • Organizohet takim me prindin • I hiqet nxënësit privilegji i kompjuterit dhe internetit për një ditë • I hiqet nxënësit privilegji i kompjuterit dhe internetit për 5 ditë • Nxënësit i hiqet përkohësisht privilegji i kompjuterit dhe internetit
Rregulli 7: Ndalohet Shkatërimi dhe Vjedhja e Pronës	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi udhëzohet të pastrojë (në se janë zhgarravina) • Nxënësi udhëzohet të shkruajë një letër ku i kërkon ndjesë viktimës, personelit mësimor dhe drejtorit; prindi e firmos letrën • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim nxënës/prind • Kërkohet dëmshpërblim ku është e mundshme • Nxënësi referohet për në Gjygin e Adoleshentëve (<i>Teen Court</i>) (Ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin- Shërbim për Komunitetin • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur dëmi është i madh, pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë e ndërhyrjes)

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat 5-12

Rregullat	Ndërhyrjet / Masat
Rregulli: 8 Ndalohet Kumari	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Nxënësi caktohet të kryejë dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prindër • Kërkohet dëmshpërblim ku është e mundshme • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>) (Ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin- Shërbim për Komunitetin • Nxënësi referohet në Grupin që lufton Kumarin (ku shihet e mundshme) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet ne programin SMART • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur shkelja e kodit është e rëndë pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë e ndërhyrjes)
Rregulli 9: Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit nga Pakujdesia	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi t'i kërkojë falje me shkrim viktimës, stafit te shkollës, drejtorit; prindi e firmos • Nxënësi caktohet të kryej dënimin • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>) (Ku shihet e mundshme) • Caktohet nxënësi në programin- Shërbim për Komunitetin • Nxënësi caktohet në klasë tjetër (ku shihet e përshtatëshme) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur shkelja e kodit është e rëndë pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë e ndërhyrjes)
Rregulli 10: Ndalohen Kërcënimet	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi t'i kërkojë falje me shkrim viktimës, stafit te shkollës, drejtorit; prindi e firmos • Nxënësi caktohet të kryej dënimin • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>) (Ku shihet e mundshme) • Nxënësi vlerësohet për Programin Ndhmës së Gjithanshme të nxënësit, Faza e I-rë (<i>CSAP Tier I</i>) • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në klasë tjetër (ku shihet e përshtatëshme) • Nxënësit i jepet pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi vlerësohet për Programin Ndhmës për Progres Akademik/Sjellje, Faza e II-të (<i>CSAP Tier II</i>) • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur shkelja e kodit është e rëndë, pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë dhe e përshtatshme e ndërhyrjes). Nëse pezullimi nga shkolla është për herë të parë, nxënësi referohet edhe për CSAP.

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat 5-12

Rregullat	Ndërhyrjet / Masat
Rregulli 11: Ndalohen Zëniet / Rrahjet	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi t'i kërkojë falje me shkrim viktimës, stafit të shkollës, drejtorit; prindi e firmos • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (Teen Court) (Ku shihet e mundshme) • Nxënësi caktohet të kryej dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi caktohet në programet Zgjidhja e Konflikteve ose referohet në programin Kontrollimi i emocioneve të Zëmërimit • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në një klasë tjetër (ku shihet e përshtatshme) • Nxënësi caktohet për pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur shkelja e kodit është e rëndë, pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë dhe e përshtatshme e ndërhyrjes). Nëse pezullimi nga shkolla është për herë të parë, nxënësi referohet edhe për CSAP.
Rregulli 12: Ndalohen Dhuna / Goditjet e lehta	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi t'i kërkojë falje me shkrim viktimës, stafit të shkollës, prindi e firmos • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>), kur është e disponueshme) • Nxënësi caktohet të kryej dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi caktohet në programet Zgjidhja e Konflikteve ose referohet në programin Kontrollimi i emocioneve të Zëmërimit • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në një klasë tjetër (nëse shihet arsyeshme) • Nxënësi caktohet për pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur shkelja e kodit është e rëndë, pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë dhe e përshtatshme e ndërhyrjes). Nëse pezullimi nga shkolla është për herë të parë, nxënësi referohet edhe për CSAP.
Rregulli 13: Ndalohen Veshjet dhe Prekjet e Pahijshme	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Udhëzohet nxënësi t'i kërkojë falje me shkrim viktimës, stafit të shkollës, prindi e firmos • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>), kur është e disponueshme) • Nxënësi caktohet të kryej dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi caktohet në programet Zgjidhja e Konflikteve ose referohet në Qëndrat që merren me problemet e Familjes • Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës • Nxënësi caktohet në një klasë tjetër (ku shihet përshtatshme) • Nxënësi caktohet për pezullim nga mësimi brënda në shkollë • Nxënësi caktohet në programin SMART • Nxënësi pezullohet nga shkolla (kur shkelja e kodit është e rëndë, pezullimi nga shkolla mund të jetë masa e parë dhe e përshtatshme e ndërhyrjes e kombinuar kjo me Qëndrat që merren me problemet e Familjes dhe Proçesi CSAP).
Rregulli 14: Ndalohen Produktet e Duhanit dhe i Mjeteve të saj	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet ngjarja me nxënësin • Konfiskohen produktet • Nxënësi caktohet të kryej dënimin (<i>detention</i>) • Organizohet takim me nxënës/prind • Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>), kur është e

NIVELI I Rregullat dhe Ndërhyrjet
Klasat 5-12

Rregullat	Ndërhyrjet / Masat
	disponueshme) <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi rekomandohet në Programin Ndhmës së Gjithanshme të nxënësit, Faza e II-të (CSAP Tier II) Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës Nxënësi caktohet për pezullim nga mësimi brënda në shkollë Nxënësi caktohet në programin SMART Nxënësi pezullohet nga shkolla
Rregulli 15: Ndalohen Droga dhe Alkoli për Përdorim Personal	<ul style="list-style-type: none"> Diskutohet ngjarja me nxënësin Konfiskohen produktet Nxënësi caktohet të kryej dënimin (<i>detention</i>) Organizohet takim me nxënës/prind Nxënësi referohet në programin për Drogën (në se shihet e mundshme) Nxënësi referohet për në Gjyqjin e Adoleshenteve (<i>Teen Court</i>), kur është e disponueshme) Nxënësi pezullohet nga privilegjet e shkollës Nxënësi caktohet për pezullim nga mësimi brënda në shkollë Nxënësi caktohet në programin SMART Nxënësi pezullohet nga shkolla

NIVELI II Rregullat dhe Ndërhyrjet ndaj Shkeljeve të Rregullores
Klasat 5-12

Rregullat	Ndërhyrja/Masat
Rregulli 16: Shkeljet e Përsëritura të kodit	Nëse shkolla ka siguruar dhe dokumentuar të gjitha masat e duhura, përfishirë këtu edhe procesin CSAP, Faza e II ^{-të} (Tier II), nxënësi duhet të rekomandohet për transferim disiplinor, duke përdorur formën disiplinore EH21.
Rregulli 17: Ndalohet Shkatërrimi dhe Vjedhja e Pronës	Nxënësi pezullohet & rekomandohet në një shkollë alternative ose përjashtohet duke përdorur formën disiplinore EH 21.
Rregulli 18: Ndalohen Frikësimi, Brutaliteti, Ngacmimet në Internet (<i>Cyber-bullying</i>)	
Rregulli 19: Ndalohen Ngacmimet, Kërcënimet	
Rregulli 20: Ndalohen Aktet Seksuale me dëshirë	
Rregulli 21: Ndalohen Dhuna Seksuale	
Rregulli 22: Ndalohen Goditjet ndaj Personelit të Shkollës	
Rregulli 23: Ndalohen Goditjet e Dhunshme	
Rregulli 24: Ndalohet Grabitja	
Rregulli 25: Ndalohet Mbajtja e Armëve	
Rregulli 26: Ndalohen Shpërndarja e Drogës/Alkolit	
Rregulli 27: Ndalohet Rrezikimi i Jetës së Personit	

PARAGRAFI 4. PROÇEDURAT DISIPLINORE

Përveç rasteve kur ka ndodhur shkelja e Nivelit II të Kodit të Sjelljes së Nxenesit ,ose kur sjellja e nxënësit paraqet rrezik për shëndetin, sigurinë dhe mirëqënien në shkollë dhe/ose komunitetin e saj, përjashtimi nga shkolla do të përdoret si opsion, kur shkollat kanë ezauruar të gjitha ndërhyrjet e duhura brenda shkollës, ashtu si përshkruhet në Kodin e Sjelljes dhe Manualin e Procedurës Disiplinore.

4.1. Proçedurat e Pezullimit nga shkolla deri në 3 ditë

4.1.1. Nxënësit që janë pezulluar, do t'ju sigurohet një takim me Drejtorin e shkollës ose personin kompetent përpara se të pezullohen. Gjatë bisedës, nxënësi duhet të jetë:

- a. i informuar ,që dyshohet se ka bërë shkelje dhe do ekzaminohen të gjithë faktorët përreth
- b. do t'i jepet një shans t'i përgjigjet akuzave n.q.se ai/ajo nuk janë përgjigjur akoma
- c. do të informohet për masat riedukuese dhe
- d. do të informohet për pasojat n.q.s do të ketë shkelje në të ardhmen

4.1.2. Pas mbledhjes me nxënësin, Drejtori ose personi i caktuar duhet të zbatojë masat riedukuese të rekomanduara dhe do t'i dërgojë prindit Njoftimin/Masën Disiplinore për ta informuar atë për shkeljen e rregullores nga ana e nxënësit, kohëzgjatjen e pezullimit dhe ditën kur nxënësi, i shoqëruar nga prindi/kujdestari, do të kthehet në shkollë për vazhdimin e mësimit.

4.2. Proçedurat e Pezullimit nga shkolla më shumë se 3 ditë

Nxënësit që pezullohen nga shkolla më shumë se tre ditë, do të zbatojnë proçedurat e parashtruara në paragrafin 4.1. Përveç kësaj, prindi/kujdestari duhet të asistojë në konsultën me drejtorin për diskutimin e shkeljes së rregullores nga nxënësi dhe rrugët për shmangjen e shkeljeve në të ardhmen.

4.3. Proçedurat për Transferime në një Shkollë Tjetër për Nxënësit e Klasave të K- 4 (Kopsht- 4).

4.3.1. Çdo nxënës, që kryen një shkelje e cila ndëshkohet me transferim në një shkollë tjetër, do të pezullohet dhe do t'i jepet mundësia të ndjekë proçedurat e përcaktuara më lart në paragrafin 4.1 dhe 4.2. Përveç kësaj, në mbledhjen me prindin do të diskutohet një Rishikim i Pasqyrës së Sjelljes së nxënësit.

4.3.2. Para se nxënësi të transferohet në një shkollë tjetër, atij duhet t'i ofrohet një gjykim jozyrtar që do të:

- a. drejtohet nga një anëtar i Zyrës së Arsimit Alternativ në Tranzicion; dhe
- b. i jepet një mundësi prindit/kujdestarit të rishikojë të dhënat e nxënësit, të paraqesë fakte dhe dëshmitarë dhe t'i bëjë pyetje dëshmitarëve të Drejtorisë Arsimore, në se janë të pranishëm.

4.3.3. Zyra e Arsimit Alternativ në Tranzicion do të marrë një vendim, nëse tranferimi është i duhur. N.q.se po, nxënësi do të transferohet.

4.4. Proçedurat e Transferimit në Shkolla Alternative për nxënësit e klasave të 5-12.

4.4.1. Çdo nxënës që kryen një shkelje, e cila ndëshkohet me transferim në një Shkollë Alternative, do të pezullohet dhe do të ndjekë proçedurat e përcaktuara në paragrafin 4.1 dhe 4.2 më sipër. Për më tepër, në konsultën prind/nxënës/drejtori do të diskutohet një Rishikim i Pasqyrës së Sjelljes së Nxënësit.

- 4.4.2.** Zyra e Arsimit Alternativ në Tranzicion do të marrë një vendim nëse transferimi është i përshtatshëm dhe do të njoh prindin/kujdestarin me vendimin.
- 4.4.3.** Përveç kësaj, nxënësit do t'i jepet mundësia e një gjykimi që:
- do të drejtohet nga një oficer i pavarur, ose koordinator i disiplinës;
 - do t'i japë një mundësi prindit/kujdestarit të rishikojë të dhënat e nxënësit, të paraqesë fakte dhe dëshmitarë, dhe t'i bejë pyetje dëshmitarëve të Drejtorisë Arsimore, nëse janë të pranishëm.

4.5. Proçedurat e Përrjashtimit.

- 4.5.1.** Çdo nxënës i cili kryen një shkelje që ndëshkohet me Përrjashtim nga shkolla, do të pezullohet edhe nga mësimi, dhe do të ndjekë proçedurat e përcaktuara në paragrafet 4.1 dhe 4.2 më sipër.
- 4.5.2.** Zyra e Arsimit Alternativ në Tranzicion do të transferojë nxënësin në një Shkollë Alternative dhe do të njohë prindin/kujdestarin me rezultatin e vendimit përrfundimtar për përrjashtim, mbas seancës së gjykimit.
- 4.5.3.** Përveç kësaj, nxënësit do t'i jepet mundësia të marrë pjesë në seancën e gjykimit për Përrjashtim, e cila do të drejtohet nga i gjithë Komisioni Reformës Shkollore (SRC), anëtarët e SRC or një gjykues i pavarur i caktuar nga SRC. Nxënësi:
- mund të përfaqësohet nga një avokat apo këshilltar i paguar nga prindi/kujdestari
 - ka të drejtë të njihet me emrat e dëshmitarëve kundër tij dhe me kopje të deklaratave apo dëshimive të këtyre nxënësve
 - ka të drejtë të kërkojë, që këta dëshmitarë të paraqiten personalisht dhe t'u përrgjigjen pyetjeve ose të ripyeten;
 - ka të drejtë të dëshmojë vetë dhe të paraqesë dëshmitarë në interes të tij.
 - ka të drejtën e Apelit në Gjykatën e lartë.

4.6. Proçedurat për Disiplinën në klasat e Arsimit Special (*Special Education*)

- 4.6.1.** Pezullime për Nxënësit e Arsimit Special me Paaftësi Mendore. Drejtoria Arsimore mund të pezullojë nga mësimi nxënësit e identifikuar me Paaftësi Mendore vetëm me (a) një marrëveshje të shkruar me prindin ose (b) në një rast emergjence, ku nxënësi përfaqëson rrezik për veten e tij ose të tjerët dhe me aprovim me shkrim nga Zyra e Arsimit Special të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë.
- 4.6.2.** Pezullim, Përrjashtim dhe Transferim për të gjithë Nxënësit e tjerë Handikapat. Drejtoria Arsimore mund të pezullojë nxënësit handikapat/me aftësi të kufizuara dhe të ndërpresë shërbimet edukative deri në 5 ditë shkolle rresht, në total 15 ditë shkolle gjithsej, gjatë një viti shkollor, duke mos i siguruar nxënësit masat mbrojtëse proçedurale të arsimit special.
- Drejtoria do të sigurojë masat mbrojtëse të mëposhtme për nxënësit e rekomanduar për Përrjashtim, transferim në një Shkollë tjetër Alternative për probleme discipline, ose Pezullim për më shumë se 5 ditë rresht, ose deri në 15 ditë gjithsej, gjatë gjithë vitit shkollor (pra nxënësi nuk pezullohet nga shkolla më shumë se 15 ditë të grumbulluara këto gjatë një viti shkollor):
 - Letër me shkrim për prindin/kujdestarin e nxënësit, ku rekomandohen masat disiplinore dhe data takimit për të analizuar problemet që ka nxënësi sipas Programit Edukimi të Individualizuar (*Individualized Education Program, IEP*);

2. një ekip, ku është ftuar dhe prindi, do të mbledhet për përcaktimin e një vendimi brënda 24 orëve të shkeljes së bërë;
3. gjatë takimit në Programin e Edukimit të Individualizuar (IEP) grupi i punës do të shohe vlerësimin aktual dhe caktimin e nxënësit në shkollë, për të përcaktuar nëse sjellja e keqe e nxënësit lidhet apo jo me Gjymtimin e tij. Sjellja e keqe, nuk është e lidhur me gjymtimin mendor nëse (i) IEP aktual është me vend dhe mund të zbatohet, dhe (ii) nëse Gjymtimi nuk e dobëson aftësinë e nxënësit për të kuptuar pasojat e sjelljes së tij/saj dhe aftësinë e tij për vetëpërmbytje.
4. Nëse, sjellja e nxënësit nuk vjen si pasoje e Gjymtimit, nëpunësit e shkollës mund të kërkojnë të zbatohet Kodi Uniform i Disiplinës, duke marrë në konsideratë edukimin special të nxënësit dhe të dhënat e tij mbi disiplinën. Por, në asnjë rast nxënësi s'mund të pezullohet më shumë se 5 ditë rresht ose 15 ditë në vit, duke mos i siguruar shërbimet e duhura në edukimin e tij.
5. Ekipi i IEP-së, do të rishikojë dhe ripunojë planin e ndërhyrjes/masave për përmirësimin e sjelljes, nqs është e nevojshme ose të bëjë një plan funksional vlerësimi të sjelljes së nxënësit dhe përcaktojë ndërhyrjet e duhura.
6. Ekipi që bën IEP do të vendosë nëse duhet një mjedis i brendshëm edukues alternativ, dhe siç u tha më parë, në këtë IEP do të përfshihen ato shërbime dhe modifikime ,që do ta bëjnë nxënësin të aftë të vazhdojë të marrë pjesë në programin mësimor, të ndryshojë sjelljen e tij dhe të mos përsërisë gabimet.
7. Ekipi i IEP do të japë një njoftim ku rekomandon për vendin e edukimit ashtu si dhe rezultatet e përfundimit, nëse sjellja e padëshiruar ka lidhje me Gjymtimin

Nëse sjellja e nxënësit manifestohet si sjellje që lidhet me aftësitë e kufizuara/gjendjen e tij, nxënësi mund të caktohet në një tjetër mjedis edukativ provizor të përshtatshëm, vetëm n.q.s nxënësi ka mbajtur armë në shkollë ose mjediset e saj,apo ka mbajtur, përdorur ose shitur apo është munduar të shesë drogë në shkollë ose në mjediset e saj. N.q.s prindi kërkon një proces tjetër gjykimi, Caktimi i Nxënësit në shkollë tjetër do të bëhet brënda 45 ditëve.

Drejtoria Arsimore mund të kërkojë të shtyjë gjykimin dhe t'i kërkojë përfaqësuesit të gjykimit të urdhërojë caktimin provizor për 45 ditë, nëse nxënësi ka premisa të plagosë veten apo të tjerët. Nxënësit me aftësi të kufizuara duhet t'i sigurohet edukimi i duhur falas (FAPE), edhe kur janë përjashtuar.

4.7 Pasojat në rast shkelje të Kodit të Sjelljes sipas të Drejtës Penale (*Criminal Justice*) dhe e të Rinjve (*Juvenile Justice*).

Përveç ndërhyrjeve të specifikuara nga Kodi i Sjelljes së Nxënësit, shkeljet që përbëjnë sjellje kriminale ose shkelje sipas Dekretit për të Rinjtë dhe Kodit të Krimeve të Pensilvanisë, përkatësisht mund të dërgojë nxënësin t'i nënshtrohet ndjekjes penale të Gjykatës së Familjes ose Gjykatës së Krimeve të të Rriturve. Një nxënës, që kryen një akt kriminal pasi ka bërë dhjetë vjeç dhe para se të bëjë tetëmbëdhjetë vjeç mund të ndiqet në sistemin e Drejtësisë Minorene. Me çështje të tilla merret Gjykata e Familjes së Filadelfias, në adresën 1801 Vine Street. Me aktet e kryera pas moshës 18 vjeç merret gjykata e të rriturve.

Megjithatë, nëse një nxënës është 15 vjeç e lart dhe kryen sulm të dhunshëm, përdhunim, dhe shmang pavidije marrdhëniet seksuale, sulm të dhunshëm të turpshëm, vjedhje ose vjedhje të një automjeti dhe **përdorë një armë vdekjeprurëse**, çështja do të ndiqet në Gjykatën e të Rriturve.

Nëse nxënësi është 15 vjeç e lart, dhe kryen një sulm të dhunshëm, përdhunim, shmang pavullnet marrdhëniet seksuale, sulm të dhunshëm të turpshëm, vjedhje ose vjedhje të një automjeti dhe **është shpallur fajtor herë tjetër për ndonjë nga këto shkelje**, çështja do të ndiqet në Gjykatën e të Rriturve.

4.8 Proçedurat për Nxënësit që kthehen nga Venddënimet e Gjykatës

Eshtë në politikën e rregull Drejtorisë Arsimore të caktojë nxënësit e kthyer nga venddënimet në shkolla dhe programe, ku do të kenë mundësi të rritin në maksimum shanset për sukses, dhe në të njëjtën kohë t'i japin rëndësinë e duhur sigurimit të përgjithshëm të shkollës në të cilën ata kthehen.

4.8.1 Kthimi nga VendDënimi. Para se të kthehet në klasë, një nxënës i kthyer nga vendi i kryerjes së dënimit do të kalojë mëparë në një program i quajtur, Program Rehabilitimi për Nxënësit e ardhur nga Dënimi (*Reentry Transition Initiative Welcome Return Assessment Program ('RETI-WRAP')*). Nxënësit duhet të ndjekin këtë program për 4 javë, ku dhe do të behet vlerësimi dhe përcaktimi i shkollës së duhur për ta.

4.8.2 Kthimi nga VendDënimi që i ka caktuar Gjykata. Nxënësit që janë kthyer nga një venddënimi i gjykatës do të vendosen në shkollat e lagjes së tyre nga Zyra e Arsimit Alternativ dhe në Tranzicion.

PARAGRAFI 5. INICIATIVA PER REDUKTIMIN E MUNGESAVE PA ARSYE NE SHKOLLE.

5.1. Ndërhyrja/Masat për frekuentimin e rregullt të shkollës/Ndihma për parandalim e mungesave pa arsye ("ATIPS") dhe Nëpunësit që merren me Prindërit e nxënësve që bëjnë mungesa pa arsye ("PTO"). ATIPS është një strategji e tërë e zhvilluar nga Drejtoria Arsimore, që përfshin bashkëpunimin me organizata komunitare, komunitetet fetare, prindër dhe anëtarë të tjerë nga zona përreth për të rritur pjesëmarrjen në shkollë dhe reduktimin e mungesave pa arsye në gjithë Qytetin. Mungesat pa arsye janë një paralajmërim që tregojnë se, nxënësi do të ketë nevojë për ndërhyrje, dhe marrja e masave do të fuqizojë dhe sigurojë burime që familja t'i japë drejtim jetës së tyre.

ATIPS mbështetet mbi mekanizmat ekzistuese në mënyrë që të sigurojë ndërhyrje për fëmijët dhe familjet para se ata të dërgohen në Gjykatë (*Truancy Court*) për mungesat e paarsyeshme, që zakonisht është për 3 ose më shumë mungesa pa arsye. Nëpunësi i mungesave pa arsye (PTO) viziton familjet e nxënësve dhe jep informacione rreth politikave të Seksionit Arsimor për mungesat, arsimin e detyrueshëm, dhe ndihmën apo mbështetjen që mund të marrin kur është e nevojshme.

5.2. Programi i Eleminimit të Mungesave pa Arsye. Programi i Eleminimit të Mungesave pa Arsye aplikohet tek të rinjtë që mungojnë duke i ri-ingranuar ata menjëherë në mjedisin shkollor. Programi i Eleminimit të mungesave pa arsye realizohet në bashkëpunim me policinë e Filadelfias dhe të SEPTA-s (kompania e shërbimit të transportit).

5.3. Qëndrat e Mungesave pa Arsye (*Truancy Centers*). Aktualisht Drejtoria Arsimore ka 2 Qendra që ndihmojnë. Qëndrat bashkëpunojnë me Programin e Eleminimit të mungesave dhe shërbejnë si shkollë për mijëra nxënës, të cilët kapen në rrugë për mungesa pa arsye.

PARAGRAFI 6. POLITIKAT

6.1 Politika Kundër-Diskriminimit dhe Kundër-Ngacmimit/Rënies në qafë

Drejtoria Arsimore ndjek një politikë shumë të ashper në ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimeve dhe ngacmimeve. Ky paragraf i Kodit të Nxënësve ka si qëllim të japë vetëm një përmbledhje të shkurtër të politikave të përgjithshme. Një pasqyrë të plotë të kësaj politike do ta gjeni në adresën elektronike: www.phila.k12.pa.us

Nxënësit kanë të drejtë të mësojnë në një mjedis pa diskriminim dhe ngacmim. Ngacmimi/brutaliteti (*Harassment*) përkufizohet si një kërkesë me ngulm për favor seksual ose çdo lloj sjellje që shqetëson, kërcënon, frikëson ose krijon një mjedis të disfavourshëm për shkak të gjinisë së personit, moshës, racës,

ngjyrës, orientimit seksual (e ditur ose e supozuar), shprehjes së identitetit, origjinës kombëtare, besimit, gjymtimit, gjëndjes shoqërore ekonomike, dhe/ose bindjeve politike. Diskriminimi është trajtimi i një individi ndryshe nga të tjerët, duke u nisur nga gjinia, mosha, raca, ngjyra, orientimi seksual (e ditur ose e marrë me mend), shprehja e identitetit të gjinisë, origjina kombëtare, besimi, gjymtimi fizik/mendor, gjëndja shoqërore-ekonomike dhe/ose bindjet politike. Në këtë listë nuk janë përfshirë të gjitha.

N.q.s një nxënës ndihet se ai/ajo është viktimë e një diskriminimi ose ngacmimi, ai/ajo duhet të raportojë një sjellje të tillë siç përshkruhet më poshtë në Paragrafin 6.2. Mbështetur në një ankesë të tillë, Drejtoria do të kryejë investigimet e plota dhe në detaje. Brënda të gjitha mundësive të lejuara me ligj, Drejtoria do të ruajë fshehtësinë e hetimit. Të gjitha palët do të trajtohen me dinjitet dhe Drejtoria nuk do të hakmerret ndaj ndonjërit që raporton këto sjellje.

Në politikën e mësipërme nuk ka asnjë pengesë që ndalon një nxënës të kontaktojë policinë n.q.s. në një çështje dyshohet të përfshihen elemente të një krimi penal.

N.q.s një nxënës ka ndonjë pyetje për Politikën e Kundër-Ngacmimit, ai/ajo duhet të kontaktojë Drejtorin/en e Shkollës ose Kryeinspektorin/en Rajonal (*Regional Superintendent*).

6.2. Ankesat/Politika e Ankesave

6.2.1. Procedura jozyrtare e Ankesave

- a. Nëse një nxënës beson se ai/ajo është ngacmuar ose diskriminuar ose ka njohuri se një tjetër është ngacmuar ose diskriminuar, nxënësi duhet të kontaktojë drejtorin/en e shkollës së tij/saj që ta raportojë këtë sjellje.
- b. N.q.s personi që akuzohet për ngacmim ose diskriminim është vetë drejtori/eshja ose n.q.s nxënësi mendon që drejtori/eshja mban përgjegjësi në një farë mënyre për këtë ngacmim ose diskriminim, nxënësi duhet të raportojë sjelljen tek Kryeinspektori Rajonal (*Regional Superintendent*) në Zyrën e Rajonit përkatës (*Regional Office*).

6.2.2. Politika Formale e Ankesave. Drejtoria e Arsimit ka një procedurë ankimi për nxënësit të cilët duan të raportojnë një ngacmim, diskriminim apo frikësim të bërë nga një anëtarë tjetër i komunitetit të shkollës. Faqja e fundit e Kodit përmban një formular për plotësim nga nxënësit në çdo rast, kur ata mendojnë se janë ngacmuar, diskriminuar, ose frikësuar nga një anëtarë tjetër i komunitetit të shkollës. Përveç kesaj procedure, nxënësit mund të raportojnë incidentet duke telefonuar në linjën direkte për ankesa (*BullyHotline*), Drejtorin/en e shkollës, ose ndonjë përfaqësues të Drejtorisë Arsimore. Më poshtë keni një kopje të procedurës:

- a. Ankuesi raporton tek Drejtori/e i/e shkollës , zëvendësi i tij/saj, ose një përfaqësues tjetër i Drejtorisë Arsimore, dhe merr një Raport për Ankesën e bërë (*Grievance Report*).
- b. Ankuesi plotëson Formularin e Raportimit të Ankimit. N.q.s. ankuesi ka nevojë ose kërkon ndihmë për përkthyes që të plotësojë formularin, shkolla ose zyra duhet të marrë masa për shërbimet e përkthimit.
- c. Një kopje do t'i jepet Drejtorit/es të Shkollës
- d. Drejtori/e i/e shkollës do të bëjë një investigim brënda 10 ditëve dhe do të marrë masat paraprake
- e. Drejtori/e i/e shkollës siguron hapjen e dosjes së Raportimit të një Incidenti Serioz, dhe Formularim e Raportit mbi Ankimin ia bashkangjit formës EH-31
- f. Drejtori/e i/e shkollës duhet t'i japë Koordinatorit të Title IX të Drejtorisë Arsimore (*Title IX Coordinator*) një kopje të Formës së Raportit të Ankesës dhe të EH-31

- g. N.q.s. dyshimi është mbi Drejtorin/en i/e shkollës, Kryeinspektori Rajonal (*Regional Superintendent*) ose zëvendësi do të bëjnë një investigim brenda 10 ditëve dhe do të marrin masat e duhura.

6.3. Politika e Kontrollit të Dollape Të Nxënësve (*Lockers*)

Drejtoria e ka të qartë nevojën e një vendi të sigurtë brenda në shkollë për librat, rrobat, materiale të shkollës, dhe gjëra të personale, që janë të nevojshme në shkollë dhe mund t'ju sigurojë kabinete dhe dollape për t'i vënë ato.

Të gjithë dollapet janë dhe do të mbeten pronë e Drejtorisë Arsimore. Nxënësit nuk mund të përdorin bashkë një dollap dhe udhëzohen t'i mbajnë dollapet që iu janë dhënë të kyçur për t'i mbrojtur nga ndonjë vjedhje. Por, asnjë nxënës s'mund të përdorë dollapin për të vendosur gjëra me vlerë apo substanca ose sende që janë të ndaluar apo që përbëjnë rrezik për shëndetin, sigurinë apo mirëqënien e një rrezëve në shkollë apo të ndërtesës së shkollës. Nxënësit nuk mund të ndryshojnë ose të zëvendësojnë kyçin që iu është dhënë nga shkolla. Shkolla ka kopje të kombinacioneve të kyçeve të dhënë.

Drejtoria ka të drejtë të autorizojë nëpunësit e tij të inspektojë dollapin e një nxënësi, n.q.s ky nëpunës dyshon se dollapi nuk është përdorur konform rregullores dhe konstaton se janë fshehur substanca apo sende kontrabandë, të cilat janë ilegale ose ndonjë material që rrezikon mirëqënien dhe rregullin e shkollës.

6.4. Të Dhënat e Nxënësit (*Student Records*).

Drejtoria ndjekë një politikë për mbajtjen e të dhënave të të gjithë nxënësve. Një kopje e kësaj politike mund ta merrni në faqen elektronike: www.phila.k12.pa.us.

6.5. Konfiskimi i Bip-erave, celulareve, dhe Aparateve të tjera Telefonike.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ndalon mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve telefonike, ose bi-perave, në territorin e shkollës, në aktivitetet shkollore dhe në autobuzat e shkollës ose automjetet e tjera, që sigurohen nga Drejtoria Arsimore.

Për më tepër, Drejtoria Arsimore ndalon përdorimin e celularëve nga nxënësit në territorin e shkollës gjatë procesit mësimor. Drejtori/e e shkollës ka autoritetin e plotë të adresojë problemet që mund të kenë për pasojë prishjen e procesit mësimor, si rezultat i përdorimit të mjeteve të telekomunikimit. Një kopje të plotë të kësaj politike mund ta gjeni në websaitin e drejtorisë arsimore: www.phila.k12.pa.us.

6.6. Politika e Shprehjes së lirë të Nxënësit

Nxënësit kanë të drejtën e të shprehurit të mendimeve të tyre, vetëm n.q.s shprehja e mendimeve nuk prek materialisht procesin edukativ, nuk përbën kërcënim për shkollën dhe komunitetin, nuk inkurajon aktivitete të paligjshme, apo nuk ndërhyr në të drejtat individuale të tjetrit. Një kopje të Politikës së Shprehjes së Nxënësit mund të gjeni tek adresa elektronike: www.phila.k12.pa.us. Të gjithë nxënësit nxiten dhe prej tyre pritet që të lexojnë Politikën e Shprehjes së lirë të Nxënësit.

PARAGRAFI 7. NUMRAT E TELEFONIT ME SHPESH NE PERDORIM

Zyra e Edukimit Alternativ në Tranzicion (<i>Office of Transition and Alternative Education</i>)	215-400-4220
Frekuentimi dhe Mungesat paarsye (<i>Attendance and Truancy</i>)	215-400-4220
Reti-Wrap (Program Edukimi gjatë tranzicionit të Nxënësit nga Qëndrat e Riedukimit drejt Shkollës së rregullt) <i>Reti-Wrap (Reentry Transition Initiative Welcome Return Assessment Program)</i>	215-875-8075
Zyra e Disiplinës së Nxënësve (<i>Student Discipline</i>)	215-400-4220
Zyra e Këshilltarit të Përgjithshëm (<i>Office of General Counsel</i>)	215-400-4120
Zyra e Caktimit të Nxënësve (<i>Student Placement</i>)	215-400-4290
Zyra e Gjuhës, Kulturës dhe Arteve (<i>Office of Language, Culture and the Arts</i>)	215-400-4240
Zyra Mbështetëse për Shkolla të Sigurta (<i>Office of Safe Schools Advocate</i>)	215-644-1277
Zyra për një Klimë të Sigurtë në Shkolla (<i>Office of School Climate and Safety</i>)	215-400-4710
Zyra e Shërbimeve të Specializuara (<i>Office of Specialized Services</i>)	215-400-4170
Linja Direkte e Informacionit dhe Prindërve (<i>Parent Support Hotline</i>)	215-400-4000
Linja Direkte e Drejtorisë Arsimore (<i>School District Safety Hotline</i>)	215-299-SAFE (7233)

Zyrat Arsimore të Rajoneve (Regional Offices)

Zyra e Rajonit të Qendrës së Qytetit (<i>Central City Regional Office</i>)	215-351-3807
Zyra e Rajonit CEO/EMO (<i>CEO/EMO Region</i>)	215-684-5132
Zyra e Rajonit Lindor (<i>East Regional Office</i>)	215-961-2066
Zyra e Rajonit Verior (<i>North Regional Office</i>)	215-456-0998
Zyra e Rajonit Verilindor (<i>Northeast Regional Office</i>)	215-281-5903
Zyra e Rajonit Veriperëndimor (<i>Northwest Regional Office</i>)	215-248-6684
Zyra e Rajonit Jugor (<i>South Regional Office</i>)	215-351-7445
Zyra e Rajonit Perëndimor (<i>West Regional Office</i>)	215-471-2271

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
Formulari për Raportimin e Ankesave të Nxënësit

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ndjekë një politikë të ashpër që ndalon të gjitha format e diskriminimit dhe ngacmimit (shiko Politikën 102). Të gjithë njerëzit do të trajtohen me respekt dhe dinjitet. Ky formular vjen në ndihmë të nxënësve për përdorim, nëse ata besojnë se janë shqetësuar ose diskriminuar nga një nxënës tjetër apo nga punonjës i Drejtorisë Arsimore. Nxënësit mund të raportojnë incidente edhe në Linjën direkte të Raportimit të Ankesave (*Bully Hotline*), tek Drejtori/esha i/e Shkollës së tyre ose tek ndonjë përfaqësues tjetër i Drejtorisë Arsimore.

Ankuesi _____ Datëlindja _____

Shkolla _____ Klasa _____ Dhoma _____

Adresa e shtëpisë _____ Numri i telefonit të shtëpisë _____

Data(t) dhe koha(ët) e Incidentit/Ngjarjes _____

Emri(at) i/e personit(ave) të diskriminuar apo ngacmuar _____

Rendit ose përshkruani dëshmitarët që ishin prezent _____

Ku ndodhi incidenti/ngjarja? _____

Përshkruani incidentin sa më qartë që të mundeni, duke përfshirë gjëra të thëna me gojë (që do të thotë: kërcënime, detyrim, etj.); çfarë kontakti fizik, nëse kishte; çfarë force u perdor, nëse u përdor; çfarë bëtë ju për të mënjanuar situatën, etj. (Bashkëngjit faqe të tjera n.q.se duhen).

Kjo ankesë dorëzohet me ndergjegjen time të plotë se _____ më ka diskriminuar dhe/ose shqetësuar. Në vijim, vërtetojse informacioni që ju kam dhënë në këtë ankesë është i vërtetë, korrekt dhe është plotësuar me shkallën më të lartë të njohurisë sime.

Firma e Ankuesit

Data

Marrë nga _____

Përfaqësues i Drejtorisë Arsimore & Detyra

Data

Unë, i Ankuari, jam pajisur me një kopje të kësaj forme nga Drejtoria Arsimore.

Firma e Ankuesit

Data

Shënim për Administratorët: Një Raport Serioz të Ngjarjes duhet të plotësohet. Bashkëngjit këtë Formular Ankimi me kopjen e shkollës të Raportit EH-31 të Ndjekjes së Incidentit në Vijim.

Informacioni në këtë manual
mund të freskohet gjatë vitit shkollor

Versionin më të fundit mund ta gjeni në websaitin (*website*) e Drejtorisë Arsimore
www.phila.k12.pa.us

Për kopje në gjuhë të tjera përveç Anglishtes, ju lutem kontaktoni:
Zyrën e Komunikimeve të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias
në numrin e telefonit: 215-400-4040

Drejtoria Arsimore e Filadelfias, ofron mundësi të barabarta për të gjithë, pa diskriminim race, ngjyre, feje, moshe, origjine kombëtare, prejardhje familjare, gjymtimi fizik, seksi, orientimi seksual, anëtarësimi në union, ose kufizimi gjuhësor. Kjo politikë e mos diskriminimit shtrihet në të gjitha klasifikimet e tjera të mbrojtura me ligj. Publikimi i këtij dokumenti është në mbështetje të plotë me ligjet e shtetit dhe ato federale, përfshirë Kreun IX të Amendamenteve mbi Arsimin të vitit 1972 dhe paragrafëve 503 dhe 504 të Dekretit të Rehabilitimit të vitit 1973. Pyetjet mund t'i drejtohen Reba Smallwood, Esp., Equal Opportunity Compliance Officer, Small Business Development, Third Floor 440 North Broad Street, Philadelphia, PA 19130, (215) 400-4380

Drejtoria Arsimore e Filadelfias
Zyra Qëndrore e Arsimit
440 North Broad Street
Philadelphia, PA 19130